



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NP KOSTT-IT SH.A PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të NP KOSTT-it sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të NP KOSTT-it sh.a (KOSTT sh.a), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përkohshme në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të NP KOSTT-it sh.a deri me 31 dhjetor 2023, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ndërmarrja nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive fikse që nga themelimi, për të siguruar se vlera e tyre kontabël nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë pas rivlerësimit në fund të periudhës raportuese.
- B1 Për sipërfaqen e tokave prej 5.68 hektar që është e regjistruar në regjistër të pasurive, ndërmarrja nuk ka dëshmi që janë në pronësi të saj. Po ashtu ndërmarrja ka në regjistrat të saj të regjistruar 11 apartamente me vlerë neto në libra 158,460€ për të cilat nuk ka informatë të statusit të tyre pronësor. Ndërsa, sipërfaqen prej 10.62 hektar ndërmarrja e ka në pronësi mirëpo nuk e kishte të regjistruar në regjistër të pasurive. Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të identifikoj vlerën financiare të mos-regjistrimit por gabimi konsiderohet material në aspektin e keq-deklarimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të NP KOSTT-it sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Ndërmarrja, në pasqyra financiare kishte të regjistruara obligime ndaj furnitorëve në vlerë 78,944€ (tri raste) të cilat figurojnë si të tilla duke filluar nga viti 2011 e tutje. Ndërmarrja nuk kishte realizuar pagesat ndaj furnitorëve edhe pse ishin plotësuar të gjitha kushtet e kontratës.
- A3 Ndërmarrja kishte nënshkruar kontratë me një operator ekonomik pronari i të cilit kishte ofertuar me dy biznese në të njëjtin procedurë të prokurimit.
- A4 Angazhimi i shërbimeve të auditimit të auditorit privat, për kundër faktit se ndërmarrja ishte subjekt i auditimit nga ZKA.
- A5 Te kontrata publike kornizë “Servisim dhe mirëmbajtja e Kamionëve me Krana” për shërbimet e kryera ishte tejkaluar vlera totale e kategorisë e cila është përcaktuar në bazë të rëndësisë së shërbimit në kategori.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjera

- 1 Sipas shënimeve të KOSTT-it obligimet ndaj KEK-ut ishin 3,939,692€ ndërsa sipas konfirmimit dhe shënimeve të KEK vlera e obligimit ishte 4,263,311€. Diferenca prej 331,988€ është si pasoj e mos pranimit të dy faturave të lëshuara si ndëshkim për vonesa në pagesën e obligimeve nga KEK.

Për këtë, KOSTT kishte dërguar shkresë për shlyerje të këtyre obligimeve me arsyen se baza e këtyre penaltive është e ndërlidhur me llogarinë balancuese të cilën KOSTT vetëm e bënë menaxhimin, kurse për shlyerje të obligimeve të ndërsjella rrjedhin nga palët të cilat shkaktajnë jo balancat. Sipas tyre vetëm nëse një palë dështon në përmbushjen e obligimeve, atëherë KOSTT domosdoshmërisht dështon në pagesën e obligimeve të palës tjetër.

- 2 Pasqyrat financiare vjetore të KOSTT sh.a për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte shprehur opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e bazës për opinionin e kualifikuar:

- 1 Ndërmarrja nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive fikse që nga themelimi, për të siguruar se vlera e tyre kontabël nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë pas rivlerësimit në fund të periudhës raportuese.
- 2 Ndërmarrja nuk kishte bërë përditësimin e regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP KOSTT-it sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i NP KOSTT-it sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të NP KOSTT-it sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të NP KOSTT SH.A. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të NP KOSTT-it sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e NP KOSTT-it sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet që kanë ndikuar në opinionin e pasqyrave financiare janë, mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata, mos përditësimi i pronave të paluajtshme me ndryshimet e ndodhura ndër vite.

Konkluzioni i pajtueshmërisë ishte ndikuar, dobësia në vlerësimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit, nënshkrimi i kontratës për auditimin e pasqyrave financiare, tejkalimi i vlerës totale të kategorisë sipas kontratës si dhe mos pagesa e obligimeve ndaj furnitorëve.

Ndërsa çështjet tjera të cilat nuk kanë ndikuar në opinion por vetëm të menaxhimi financiar dhe i pajtueshmërisë janë, mungesa e rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurive, planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të prokurimit, aplikimi i kriterëve të përzgjedhjes jo në harmoni me LPP, si dhe mungesa e politikës së provizionimit të stoqeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e burimeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm

Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre tetë (8) rekomandime të reja dhe dy (2) rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes**Gjetja**

Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Kosto e një zëri të pasurive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihet si pasuri nëse dhe vetëm nëse: (a) është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen kësaj pasurie do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe (b) kosto e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Matja dhe njohja e një zëri të pasurive afatgjata materiale do të bëhet bazuar në koston e tyre. Kosto e një zëri të pasurive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) është ekuivalent i çmimit në mjete monetare në datën e njohjes. Pas njohjes si një pasuri, një zëri i pasurive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Nëse një zëri i pasurive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e pasurive afatgjata materiale së cilës i përket pasurisë.

Në vitin 2006, me procesin e ndarjes, NP Kostt sh.a i janë transferuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) pasuritë e nevojshme për funksionim të pavarur të saj. Regjistrimin e tyre në regjistrat kontabël ndërmarrja e kishte bërë me vlerat e tyre neto ashtu siç i janë dorëzuar nga KEK. Zërat e ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve në regjistrat e Kostt-it ishin prezantuar me vlerat fillestare të pasurive (minus zhvlerësimi i akumuluar) të vlerësuar nga një konsulent i pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare më datë 1 Janar 2005. Nga ajo periudhë ndërmarrja nuk kishte bërë tutje ri-vlerësimin e pasurive.

Si rrjedhojë, në regjistrin e pasurive figurojnë 4,467 pasuri me kosto historike 51,751,886€ që janë të zhvlerësuar plotësisht dhe vlera e tyre neto në libra është zero. Për me tepër, në kuadër të pasurive me vlerë neto zero, gjenden 453 pasuri të cilat nuk kishin fare kosto historike në momentin e regjistrimit. Prej tyre 38 toka, 10 ndërtesa, 26 rrugë, 151 pajisje të rrjetit dhe 228 pajisje tjera.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti e kishte konsideruar industri specifike dhe vështirë të zbatueshme rivlerësimet e pasurive në praktikë.

Ndikimi

Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre në datën e raportimit të pasqyrave financiare, të jetë me vlera materialisht të ndryshme nga vlera e drejtë e tyre.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtoreve të siguroj se do të kryhen rivlerësimet e pasurive që të sigurohet se vlera e prezantuar e pasurive në pasqyra financiare nuk ndryshon materialisht nga vlera e tyre e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Mos përditësimi i regjistrit të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme.

Gjetja

SNK 16, toka, ndërtesa dhe pajisjeje janë zëra material që mbahen për përdorim në prodhim ose furnizimin e të mirave ose shërbimeve për dhënie me qira palëve të treta ose për qëllime administrative dhe pritet të përdoren gjatë më shumë së një periudhë. Ndërsa, Korniza Konceptuale në paragrafin 4.11 përcakton që zotërimi ligjor i një objekti fizik mund të sjellë një sërë të drejtash, përfshirë, të drejtën për të përdorur objektin, të drejtën për të shitur të drejta mbi objektin, të drejtën për ta lënë peng objektin dhe të drejta të tjera.

Në regjistrat kontabël të pasurive janë të përfshira 50 parcela të tokës të trashëguara nga KEK, mirëpo sipas dëshmimeve të ndërmarrjes nuk e ka të definuar statusin pronësor për të gjitha pronat e trashëguara.

Ndërmarrja nuk kishte përditësuar regjistrin e pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme, si në vijim:

- Për 10 mostra të testuara të tokave me sipërfaqe totale 5.68 hektar të cilat figurojnë në regjistrin e pasurive, ndërmarrja nuk posedon certifikatë të pronësisë. Për më tepër ndërmarrja nuk ka informata tjera përcjellëse lidhur me vendndodhjen e tyre të saktë dhe nëse të njëjtat janë në shfrytëzim të ndërmarrjes.
- Sipas regjistrit të siguruar nga zyra ligjore në të cilin janë të specifikuar parcelat të cilat janë në pronësi të saj, ndërmarrja ka në pronësi sipërfaqet e tokave prej 10.62 hektar në zona të ndryshme kadastrale por të njëjtat nuk janë të regjistruara në regjistrat e ndërmarrjes.
- Po ashtu, kishte dallime në mes të sipërfaqeve të regjistruara në fletët poseduese krahasuar me ato që janë në regjistër të pasurive. Sipas fletës poseduese ndërmarrja ka në pronësi sipërfaqen prej 34.92 hektar në Obiliq (Kosova B) ndërsa në regjistër figuron sipërfaqja prej 25.30 hektar. Pra një diferencë prej 9.6 hektar.
- Përveç kësaj, ndërmarrja ka të regjistruar pronat e paluajtshme në regjistrin e pasurisë të përmbledhura nga fletët poseduese dhe jo veç e veç sipas numrit të parcelave. Fakti që fletët poseduese përmbajnë numër të madh të parcelave dhe në disa raste edhe lloje të ndryshme të pronës brenda të njëjtës fletë poseduese si tokë rurale, pyjore, ndërtesë, kanë pamundësuar në identifikimin e vlerës së drejtë të pronave individualisht.
- Tutje, ndërmarrja ka në regjistrat të saj të regjistruar 11 apartamente me vlerë neto në libra 158,460€. Për këto apartamente ndërmarrja nuk ka informatë të statusit të tyre pronësor. Edhe sipas raportit të komisionit të inventarizimit, ky komision e kishte të pamundur identifikimin e këtyre apartamenteve dhe për të njëjtat nuk kishte dhënë informata të tjera nëse të njëjtat janë në shfrytëzim nga ndërmarrja.

Edhe pse ndërmarrja kishte formuar komisione përkatëse për identifikimin e saktë të pronave, një gjë e tillë nuk ishte bërë për shkak të diferencave që ekzistojnë në sipërfaqe të tokave të regjistruara në regjistrin e pasurive të bartura nga KEK-u dhe fletëve poseduese të dërguara nga zyra ligjore.

Ndikimi

Mos përditësimi i regjistrin të pasurisë me gjendjen aktuale të pronave të paluajtshme ndikon në nënvlerësimin përkatësisht mbivlerësimin e vlerës së pasurisë afatgjatë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve të siguroj së janë marrë veprimet e nevojshme për trajtimin e çështjeve pronësore të ndërmarrjes dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe drejt pasurinë afatgjatë të ndërmarrjes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Dobësi në vlerësimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit

Gjetja

Neni 26 (pikat 11 dhe 12) i rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik thekson se OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodh kjo atëherë tenderi do të refuzohet. Nëse një OE në një aktivitet të prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurren si i vetëm, ndërsa në një Lot tjetër në grup, kjo kompani nuk mund të dorëzojë deklaratën që konfirmon se ai anëtar nuk është duke marr pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe rrjedhimisht të dy ofertat refuzohen. Ndërsa neni 31.4 thekson se AK do të deklarojë në Dosje të Tenderit që një OE mund të dorëzojë një tender, kërkesë për pjesëmarrje ose dokument tjetër që kërkohet ose lejohet të dorëzohet gjatë administrimit të aktivitetit të prokurimit.

Me datën 30.10.2022, ndërmarrja kishte publikuar dosjen e tenderit për projektin “Furnizim me pajisje mbrojtëse për nënstacione”. Në këtë procedurë kishin dorëzuar ofertë dy operator ekonomik. Fillimisht ndërmarrja kishte eliminuar OE me çmimin më të lirë për shkak të mos përmbushjes së specifikave teknike dhe kishte shpallur fitues OE ekonomik të dytë me çmimin më të lirë. Pas ankesës nga OE i eliminuar, ndërmarrja kishte kthyer procesin në rivlerësim ku pas këtij procesi ishte aprovuar ankesa OE të eliminuar. Ndërsa OE i cili fillimisht ishte shpallur fitues, pas rivlerësimit ishte shpallur i papërgjegjshëm për shkak të mos përmbushjes së një specifike teknike që nuk ishte pjesë e ankesës. Kontrata ishte nënshkruar me datë 01.01.2023 me operatorin që kishte parashtruar ankesë në vlerë 23,936€.

Pas analizimit të dokumenteve të regjistrimit të biznesit dhe verifikimit të tyre në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës, të dy operatorët që kishin ofertuar në këtë proces tenderues kishin të njëjtin pronar të biznesit. Si rrjedhojë, ndërmarrja në këtë rast do të duhej të bëjë anulimin e procedurës së tenderit në harmoni me kërkesat ligjore.

Nënshkrimi i kontratës në këtë rast, kishte ndodhur për shkak të mos verifikimeve të duhura nga personat përgjegjës të prokurimit të kërkesave të përshtatshmërisë profesionale.

Ndikimi

Dorëzimi i tenderëve në një aktivitet prokurimi që ka për qëllim dhënien e një kontrate publike nga OE me të njëjtin pronar biznesi, dëmton konkurrencën, ju lejon operatorëve që të manipulojnë me ofertat dhe mund të shkaktoj dëme materiale apo pranimin e produkteve jo cilësore.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe procesit të nënshkrimit të kontratave departamenti i prokurimit kujdeset që janë zbatuar parimet e konkurrencës së mirëfilltë dhe se me kontratë shpërblehet vetëm operatorët e përgjegjshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Nënshkrimi i kontratës për auditimin e Pasqyrave Financiare

Gjetja

Sipas nenit 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pika 3 Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti. Po ashtu, sipas nenit 33.3 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i ndryshuar dhe i plotësuar), Auditimin e Pasqyrave Financiare do ta bëjë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në të kundërtën, Zyrtari i Prokurimit i NP-së do të prokurorë shërbimet e një auditori për kryerjen e auditimit të jashtëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik dhe me nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Kontrata përkatëse do të ketë kohëzgjatje prej tri (3) viteve. Po ashtu sipas Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 18, pika 4, citon : Zyra Kombëtare e Auditimit mund të kryej auditime të detyrueshme të rregullsisë në Ndërmarrjet Publike. Auditori i Përgjithshëm informon Aksionarin më së voni me 30 shtator të vitit aktual mbi atë se cilat nga këto auditime do të kryhen.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) e kishte njoftuar me kohë KOSTT-in se do të jetë subjekt i auditimit nga ZKA për auditimin e pasqyrave financiare sipas kërkesave të SNRF-ve për vitin 2023.

Pavarësisht kësaj, ndërmarrja me datën 12.12.2023 kishte lidhur kontratë për shërbime të auditimit të Pasqyrave Financiare për vitet 2023-2025 në vlerë totale 44,250€, për dy raporte të auditimit, raportin e auditimit për PFV sipas kërkesave të SNRF-ve dhe raportin e auditimit sipas kërkesave nga udhëzimet rregullative të kontabilitetit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Raporti i fundit ishte obligim i KOSTT ndaj ZRRE.

Ndikimi

Angazhimi i shërbimeve të auditimit edhe nga auditori privat, për kundër faktit se ishte subjekt i auditimit nga ZKA, krijon paqartësi tek lexuesit e pasqyrave financiare dhe vet ndërmarrjes për shkak të opinioneve dhe konkluzioneve të ndryshme që mund të rezultojnë.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që në rastin e angazhimi të Zyrës Kombëtare të Auditimit për shërbime të auditimit të PFV, të mos bëhen shpenzimet të pa nevojshme për auditim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Mos pagesa e obligimeve ndaj furnitorëve**Gjetja**

Në kontratat e nënshkuara me Operatorët Ekonomik (OE) për punë dhe furnizime, neni 29 Llogaritja përfundimtare, pika 3 tek "Kushtet e përgjithshme të kontratës" theksohet që menaxheri i projektit do të lëshojë të autoriteti kontraktues ose të përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe të kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtare të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të menaxheri i projektit. Ndërsa neni 27.2 thekson se shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në nenin 29.

Gjatë testimit të obligimeve të prezantuara në PVF, në tri raste kemi vërejtur që ndërmarrja kishte të regjistruara obligime ndaj furnitorëve në vlerë 78,944€, të cilat figurojnë si të tilla që nga viti 2011 e tutje. Ndërmarrja nuk kishte realizuar pagesat ndaj furnitorëve edhe pse ishin plotësuar të gjitha kushtet e kontratës.

Kjo për faktin se, gjatë implementimit të kontratave është aplikuar ndalesa prej 5% nga çdo pagesë të faturës së pranuar ndaj OE për tu mbajtur në emër të garancionit për punë dhe furnizim deri në lëshimin e deklaratës së llogarisë përfundimtare. Pas skadimit të periudhës së garancisë, menaxheri i projektit kishte lëshuar çertifikatën për pranimin përfundimtar në të cilën specifikon se OE i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës. Përkundër kësaj, ndërmarrja nuk kishte realizuar pagesat ndaj operatorëve duke reflektuar në obligime të papaguara ndër vite.

Arsyeja e mos pagesës së këtyre obligimeve sipas zyrtarëve të ndërmarrjes ishte sepse OE nuk kishin parashtruar kërkesë formale për realizimin e këtyre pagesave. Megjithatë, zyrtarët e ndërmarrjes do të duhej të analizonin dhe respektonin kushtet e kontratës.

Ndikimi

Mos pagesa e obligimeve në periudhën kur ishte e paraparë me kontratë përveç që është në kundërshtim me kushtet e kontratës, ndikon në rritje të panevojshme të obligimeve dhe mund të shpie në pagesa të dyfishta ose pagesa me të larta për shkak të vonesave në pagesë.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që në rastet e aplikimit të parasë së mbajtur gjatë implementimit të kontratave, pas përfundimit të periudhës garantuese dhe lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare, të realizohen pagesat e plota në harmoni me kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Tejkalmi i vlerës totale të kategorisë sipas kontratës**Gjetja**

Neni 54.15 i Rregullores për Prokurim Publik sa i përket kontratave kornizë me çmime për njësi, përcakton: Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Çmimi për njësi i peshuar (poentuar) sipas kategorive, AK është i obliguar që në Dosje të Tenderit të specifikoj normën e peshimit (poentimit) për çdo kategori. Gjatë realizimit të Kontratës Publike Kornizë - Shërbime, Ofruesi i Shërbimeve, faturimin e bënë duke u bazuar në shërbimet e kryera dhe çmimet për njësi të shërbimeve të kontratës (jo çmimeve të peshuara), por nuk lejohet të kaloj vlerën sipas kategorive dhe vlerën totale të parashikuar të kontratës.

Te kontrata publike kornizë "Servisim dhe mirëmbajtja e Kamionëve me Krana" (çmimi për njësi i peshuar sipas kategorisë) e nënshkruar me datën 25.11.2020 në kohëzgjatje prej 36 muaj, kemi vërejtur që për shërbimet e kryera ishte tejkualuar vlera totale e kategorisë e cila është përcaktuar në bazë të rëndësisë së shërbimit në kategori. Vlera e tejkualuar për kategorinë dy (2) është 23,000€ dhe kategorinë katër (4) është 10,000€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të poentimit jo të duhur të kategorive përkatëse si dhe nga kujdesi jo i duhur në respektimin dhe interpretimin e kërkesave ligjore.

Ndikimi

Tejkalmi i vlerës së kategorisë sipas kontratës përveç që është në kundërshtim me kërkesat ligjore, mund të shpie në keq menaxhim të kontratës, tejkalmi të vlerës së lejuar ose shpëputje të parakohshme të saj.

Rekomandimi A5

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që janë forcuar kontrollet në mënyrë që pagesat për shërbimet e kryera nuk tejkalojnë vlerën totale të kategorisë e cila është përcaktuar në bazë të rëndësisë së shërbimit në kategori.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Stoqet

Vlera e stoqeve e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 4,595,000€. Ky zë financiar kryesisht përfshinë pajisje rezervë, materiale të imëta dhe të tjera të cilat janë të lidhura me funksionimin e ndërmarrjes.

Çështja B2 - Mungesa e politikës për provizionimin e stoqeve

Gjetja SNK 2 në pikën 28 përcakton që kosto e inventarëve mund të mos jetë e rikuperueshme kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetërsuara ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë renë. Kosto e inventarëve mund të mos jetë e rikuperueshme nëse janë rritur kostot e çmuara të përfundimit ose kostot e çmuara që duhet të kryhen për realizimin e shitjes. Praktika e zhvlerësimit të inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme është në koherencë me pikëpamjen që pasurit nuk duhet të mbahen me shuma mbi ato që pritet të realizohen nga shitja apo përdorimi i tyre.

Stoqet e prezantuara në pasqyra financiare ishin në vlerën 4,595,025€, ku prej tyre 3,824,595€ ishin pajisje rezervë. Ndërmarrja për qëllim të sigurisë së sistemit në kuadër të kësaj kategorie mban pajisje rezervë për zëvendësimin e pjesëve të cilat për arsye të ndryshme duhet të zëvendësohen. Megjithatë gjatë testimit të kësaj kategori kemi vërejtur që një numër i lartë i tyre janë regjistruar në regjistrin e stoqeve në periudha më të hershme se 10 vite.

Në 11 raste të testuara, pajisjet në vlerë 436,474€ ishin regjistruar në regjistrin e stoqeve në vitet 2013-17 dhe të njëjtat nuk kishin pasur asnjëherë lëvizje nga depo, e për të cilat ndërmarrja nuk kishte bërë rishikimin e vlerës së tyre. Përveç kësaj, ndërmarrja posedon në regjistër si stoqe pajisje të pranuar nga KEK në procesin e ndarjes dhe disa prej të cilave nuk ishin funksionalizuar asnjëherë.

Si rrjedhojë, ndërmarrja nuk ka ndonjë politikë të shkruar dhe nuk ka bërë provizionim të stoqeve që nga viti 2012. Përveç tjerash, nuk posedon një sistem të digjitalizuar lidhur me menaxhimin e stoqeve në depo dhe ky proces realizohet në formë manuale përmes regjistrimit në kopje fizike të hyrje/daljeve të artikujve/pajisjeve.

Pajisjet rezervë sipas menaxhmentit mbahen për nevoja të ndërmarrjes dhe nuk janë për shitje të mëtejme. Si rrjedhojë nuk është paraparë provizionimi i tyre në baza të rregullta por vetëm sipas vlerësimit të menaxhmentit. Megjithatë, menaxhmenti do ta shqyrtoj këtë çështje në të ardhmen dhe do të vendos se si do të veprojmë me tutje.

Ndikimi Mos rishikimi i vlerës së stoqeve që mbahen në depo për periudha relativisht të gjata, mund të ndikoj në prezantim jo të saktë të vlerës së tyre në pasqyra financiare vjetore.

Rekomandimi B2 Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që të hartohet një procedurë e provizionimit të stoqeve mënyrë që provizionimi i tyre të bëhet në bazë të disa parametrave specifik si lëvizshmëria, gjendja fizike, ndërrimet teknologjike etj. Ndërsa për stoqet e vjetra, të cilat nuk pritet që të përdoren në periudhat e ardhshme të përcaktohet trajtimi i tyre i mëtejme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e zërit financiar të pasurive afatgjata të prezantuara në pasqyrën financiare të pozicionit financiar ishte 123,065,000€. Ato kanë të bëjnë me tokat, ndërtesat dhe rrjeti i transmisionit, impiantet dhe makineritë, pajimet dhe orendi. Ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 19,841,542€.

Çështja A6 - Mungesa e rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurive

Gjetja

Sipas SNK 8 “Politikat Kontabël”, një njësi ekonomike zgjedh dhe zbaton politikat e tij kontabël me qëndrueshmëri për transaksione, ngjarje dhe kushte të tjera të ngjashme. Sipas këtij standardi politikat kontabël janë parimet, bazat, marrëveshjet, rregullat dhe praktikat e veçanta që zbatohen nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Përveç kësaj, neni 7 i statutit të ndërmarrjes thekson se ndërmarrja duhet të nxjerrë rregulloret që përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes.

Ndërmarrja nuk kishte hartuar politika të gjykimeve dhe vlerësimeve kontabël që do të përfshinte mënyrat ose kriteret në bazë të së cilave pajisjet duhet të regjistrohen si pasuri në përgatitje ose si stoqe. Ndërmarrja kishte të regjistruara në regjistrin e pasurive në përgatitje pajisje rezervë nga viti 2008 të cilat nuk kishin hyrë në funksion (vlera e pajisjeve të regjistruara nga viti 2008 deri në vitin 2013 ishte 383,463€). Po ashtu, ndërmarrja ka të regjistruara edhe në regjistrin e stoqeve pajisje rezervë në vlerë 3,825,000€.

Sipas informatave zyrtare, klasifikimi i këtyre pajisjeve në kategoritë përkatëse bëhet sipas gjykimit profesional të komisioneve teknike, të cilët duke u bazuar në specifikimet teknike të pajisjeve ata vlerësojnë se si të trajtohen pjesët rezervë, si pasuri në përgatitje që pastaj me futjen në përdorim do të regjistrohen si pasuri aktive për të cilat fillon edhe aplikimi i shpenzimeve të zhvlerësimit, apo si stoqe që me hyrjen në përdorim njihet si shpenzim i periudhës. Gjithashtu, ndërmarrja nuk kishte të aprovuara rregullore ose procedura të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.

Arsyeja e mos hartimit të rregullave dhe politikave lidhur me procesin e menaxhimit të pasurive ishte për shkak se menaxhmenti e kishte konsideruar si të mjaftueshme hartimin e manualit financiar ku përshkruhen normat e zhvlerësimit që aplikon ndërmarrja dhe përshkrimin e procesit të inventarizimit të pasurive. Ndërsa mos definimi i kriterëve përcaktues se kur një pajisje regjistrohet si pasuri dhe kur si stok ishte për shkak të natyrës dhe nevojave specifike të ndërmarrjes.

Ndikimi

Mungesa e rregullave dhe politikave lidhur me procesin e menaxhimit të pasurive përveç që mund të ketë për pasojë keq deklarimet e zërave material mund të shkaktojë edhe humbjet, keq përdorimet dhe përdorimin e paautorizuar të tyre.

Rekomandimi A6 Bordi i Drejtorëve të siguroj një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe klasifikimit të pasurive në kategori përkatëse. Po ashtu, duhet të sigurojë që brenda një afati sa më të shkurtër, të ndërmarrë veprime konkrete për të hartuar dhe futur në zbatim rregullore të brendshme për menaxhim të pasurive, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për regjistrimin dhe përdorimin e pasurive dhe përgjegjësitë të shpërndahen në bazë të një sistemi të qartë dhe të dokumentuar të delegimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në shumën 109,908,782€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE), shpenzimet e humbjeve të energjisë, shpenzimet e shërbimeve ndihmëse/Rregullimi Sekondar, shpenzimet e humbjeve të energjisë në transimion, shpenzimet e tranzitit të energjisë elektrike, shpenzimet e interesit të huamarrjeve, shpenzimet e mirëmbajtjes së mjeteve themelore, shpenzime administrative dhe shpenzime tjera operative. Ne kemi testuar 70 mostra për testimet substanciale të detajeve në vlerë 47,669,939€.

Çështja A7 - Aplikimi i kriterëve të përzgjedhjes jo në harmoni me LPP

Gjetja Sipas nenit 68 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do të referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Në dosjet e tenderit për shtatë (7) aktivitete të prokurimit të testuara, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si kriter të përzgjedhjes, ndërmarrja kishte aplikuar edhe kërkesën për qarkullimin minimal nga fusha specifike. Mirëpo kjo kërkesë nuk ishte aplikuar në harmoni me kërkesat ligjore pasi që ndërmarrja kishte kërkuar që OE të këtë së paku një kontratë në lidhje me furnizime të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit duke mos specifikuar vlerën minimale të kontratës. Ndërsa si dëshmi kishte kërkuar një listë që specifikon secilin nga projektet e OE që tregojnë vlerën, datën, llojin dhe vendin e projektit, të dëshmuara me një certifikatë të pranimit apo një referencë përgjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Kjo kërkesë ishte aplikuar tek projektet e mëposhtme:

- “Furnizimi me Izolator, Elemente Lidhëse, Kleme dhe Koka Kabllorike”;
- “Furnizim me Rimorkio për Bartje”;
- “Furnizimi dhe Montimi i Gjeneratorit 70 kVA”;
- “Furnizimi me Vegla Pune dhe Instrumente”;
- “Furnizimi dhe instalimi i baterive industriale pa mirëmbajtje”;
- “Furnizimi me Pajisje Mbrojtëse për Nënstacione”; dhe
- “Furnizim me Harduer të TIK”.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo ka ndodhur për shkak të vendosjes së kriterëve minimale në mënyrë që të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë.

- Ndikimi** Aplikimi i kriterëve të paqarta dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore pamundëson vlerësimin në mënyrë objektive të ofertave, madje mund të shpie tek lidhja e kontratës me OE që nuk ka kapacitet teknike reale për realizimin e kontratave përkatëse.
- Rekomandimi A7** Bordi i Drejtorëve të siguroj se aplikimi i kriterëve përkatëse bëhet në harmoni të plotë me kërkesat ligjore në mënyrë që të rekomandohen për kontratë OE që kanë kapacitetet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A8 - Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të prokurimit

- Gjetja** Neni 5.1 i Rregullore së Prokurimit Publik thekson se planifikimi i prokurimit është proces i mbledhjes së të dhënave mbi nevojat e autoritetit kontraktues të përmbledhura në dokument me shkrim i cili duhet të përmbajë të gjitha informacionet siç kërkohen në Formularin Standard B01 “Planifikimi i Prokurimit”. Po ashtu neni 16 i Ligjit për Prokurimin Publik thekson se autoriteti kontraktues nuk do të zgjedh ose përdor metodën e vlerësimit me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 për klasifikimin e kontratës publike sipas vlerës së parashikuar; dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji.

Për vitin 2023, ndërmarrja kishte hartuar planin e prokurimit me 86 procedura me vlerë totale të parashikuar 13,141,653€. Gjatë vitit, ishin nënshkruar 111 kontrata në vlerë prej 1,193,733€ prej të cilave 67 ishin realizuar përmes procedurës së vlerës minimale.

Kryesisht furnizimet/shërbimet me vlera minimale ishin:

- Tetë (8) kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në vlerë 7,315€, gjashtë (6) prej të cilave janë nga i njëjti operator ekonomik;
- Pesë (5) kontrata për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të llojit VW në vlerë 3,634€, katër (4) prej të cilave janë nga i njëjti operator ekonomik;
- Katër (4) kontrata me material për zyrë në vlerë 3,622€;
- Tri (3) kontrata për furnizim me material promovues në vlerë 2,843€;
- Ndërsa nga dy (2) kontrata janë aplikuar për furnizim me laptop në vlerë 1,765€ si dhe furnizim me material për mirëmbajtje për NSQ në vlerë 1,517€.

Po ashtu, kemi vërejtur që për projektin “Furnizim me Pjesë Rezervë për Nënstacione” i përfshirë në planin e prokurimit në vlerë të parashikuar 300,000€ ishin iniciuar 4 aktivitete të prokurimit dhe nënshkruar kontratat përkatëse.

Sipas zyrtarëve, kjo ka ndodhur nga mos arritja e nënshkrimit të kontratave kornizë për shkak të vonesave në shqyrtimin e ankesave të OE në OSHP për projektet mirëmbajtja e veturave dhe heqja e barit. Si rrjedhojë është paraqitur nevoja për evitimin e pengesave për sigurinë e objektit dhe funksionimin e punës në teren. Ndërsa për rastet tjera kjo ka ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur nga njësitë e kërkesës.

Ndikimi

Ndarja procedurave apo shmangia e procedurave të hapura mund të ndikojë në ekonomikitetin e aktivitetit të prokurimit, çmimet e ofertave për sasi më të vogla mund të jenë më të larta se çmimet e ofertave për sasi më të mëdha. Po ashtu, mos përfshirja e projekteve si të ndara në planin e prokurimit mund të ndikoj negativisht në procesin e menaxhimit të projekteve në kuadër të departamentit të prokurimit.

Rekomandimi A8

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë funksionim të mirë të komunikimit të brendshëm në mes njërive kërkuese dhe departamentit të prokurimit. Po ashtu, të sigurojë një planifikim të detajuar të aktiviteteve të prokurimit i cili do të shmangë në të ardhmen nevojat për ndarjen e kërkesave, si dhe do të sigurojë aplikimin e procedurave të duhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Auditimi për PFV-të e vitit 2022 të Ndërmarrjes Publike KOSTT sh. a. ishte kryer nga një kompani e kontraktuar e auditimit. Raporti i auditimit (Letër Menaxhmenti) për vitin 2022 të KOSTT sh.a kishte rezultuar me 10 rekomandime. Ndërmarrja kishte përgatitur një plan veprimi ku është paraqitur mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar; tri (3) nuk aplikohen më dhe dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar ende. Gjatë kësaj periudhe janë zbatuar rekomandimet që kanë të bëjnë fushën kontrolleve të brendshme lidhur me azhurnimet e nevojshme për detyrime kontingjente, menaxhimin e rrezikut si dhe çështjeve që kishin të bëjnë shpenzimet e pagave.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në grafikun dhe tabelën në vijim.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë që Kompania të bejë azhurnimet e duhura në agjencitë shtetërore: si Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës pas çfarëdo ndryshimi në statutin dhe emërimet e reja në top menaxhment edhe ndryshimet e mëdha statutore.	Ndërmarrja kishte aplikuar për të bërë ndryshimet në Agjencinë për Regjistrimin e Biznesit të Kosovës, mirëpo sipas këtij agjencioni ndryshimet statusore nuk mund të azhurnohen përderisa sa numri i anëtarëve të bordit nuk përmban kuotën 50% të pjesëmarrjes së grave në bord. Vendimin për emërimin e bordit e merr Kuvendi i Kosovës dhe si rrjedhojë kjo çështje nuk mund të implementohet nga ana e KOSTT deri në kryerjen e mandatit të bordit aktual.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë që Kompania të zhvillojë politika për zbatimin të azhurnimit periodik dhe të vlerësoj çështjet gjyqësore.	Raporti për çështje ligjore azhurnohet në baza të rregullta të tremujore.	I zbatuar
3.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë që Kompania të marrë në konsideratë zbatimin e një sistemi të menaxhimit të rrezikut.	Menaxhmenti ka hartuar Draft Politiken për menaxhim të rrezikut e cila pritet të miratohet nga Bordi në mbledhjen e ardhshme.	I zbatuar

4.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Ne rekomandojmë KOSTT SH.A. te marrin në konsiderate sugjerimet e mëposhtme duke marre parasysh që kapaciteti i energjisë së transmetuar nga rrjeti – pasuritë fikse te KOSTT janë shumë të larta dhe mund të shkaktojnë dëme të mëdha materiale dhe civile: Krijimi i rezervave për kompensime nga demet e shkaktuara nga pasuritë fikse të ndërmarrjes ne mjedis dhe civilizime, i lejon ndërmarrjes të zvogëlojë rrezikun dhe humbjet kur ndodhin kompensimet nga pasuritë fikse të kompanisë.	Ndërmarrja në kontratat investuese parasheh masat duke kërkuar polisa të siguri për të gjitha demet eventuale që shkaktohen mbi palët e treta. Po ashtu është i ndarë edhe buxheti për kompensimin e palëve për shpronësime dhe servitute.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Stoqet	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që të hartohet një procedurë e provizionimit të stoqeve mënyrë që provizionimi i tyre të bëhet në bazë të disa parametrave specifik si lëvizshmëria, gjendja fizike, ndërrimet teknologjike etj. Ndërsa për stoqet e vjetra, të cilat nuk pritet që të përdoren në periudhat e ardhshme të përcaktohet trajtimi i tyre i mëtejshëm.	Kjo çështje nuk ishte zbatuar. Shih çështjen B2	Nuk është adresuar
6.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të siguroj së janë marrë veprimet e nevojshme për trajtimin e çështjeve pronësore të ndërmarrjes dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe drejt pasurinë afatgjatë të ndërmarrjes.	Kjo çështje nuk ishte zbatuar. Shih çështjen B1	Nuk është adresuar
7.	Pasuritë afatgjata	Ne i rekomandojmë Kompanisë që të zhvilloj, azhurnoj sistemin dhe të mbajë një listë të plotë të pasurive dhe bazave të tyre tatimore dhe vlerës kontabël në mënyrë që të sigurojë një kalkulim të saktë të shpenzimeve tatimore, të ardhurave të tatueshme dhe çdo detyrimi dhe / ose pasurie tatimore të shtyrë duke u bazuar në secilin aset dhe jo në grup.	Kalkulimi i të ardhurave/shpenzimeve tatimore dhe çdo detyrimi dhe / ose pasurie tatimore të shtyrë realizohet verifikohen duke u bazuar në shumën bartëse të neto pasurive të kompanisë dhe bazës tatimore të pasurive të KOSTT, të cilat e vërtetojnë çdo rezultat të këtyre zërave në Pasqyrat Financiare.	I zbatuar

8.	Pasuritë afatgjata	<p>a) Rekomandojmë të zhvillohet strategjia për zhvillimin e TI-se si dhe të vendosen mekanizmat e duhur për të siguruar se ajo po zbatohet. b) Për të mundësuar arritjen e qëllimeve, por edhe të vendosjes së mbikëqyrjes, kompania duhet të përditësoj dhe përshtat me veprimtarinë politikat e saj të sigurisë. Po ashtu duhet zhvilluar dhe zbatuar dokumentet e tjera përcjellëse, si procedurat, udhëzuesit dhe dokumente të tjera relevante, të cilat rrjedhin nga politikat e sigurisë së informacionit dhe të njëjtat të jenë në dispozicion të personelit relevant për t'i zbatuar. c) Kompania duhet të siguroj ndarjen adekuate të përgjegjësive duke angazhuar personel të mjaftueshëm apo duke vendosur masa kompensuese të kontrollit në rastet kur ndarja e përgjegjësive nuk mund arrihet plotësisht. d) Ne rekomandojmë që Kompania të kodojë të gjitha kopjet rezerve që dërgohen dhe ruhen jashtë faqes kryesore të të dhënave (dhoma e serverit ose qendra e të dhënave). Rishikimi kopjeve rezerve duhet të transferohet në mënyrë dixhitale dhe jo fizike. e) Të sigurohet që testet e rikthimit rezerve të behën siç parashikohet në Politiken e Korporatave dhe që rezultatet të raportohen në Menaxhimin e TIK. Për më tepër, të rishikohet nëse një procedure e tillë e rëndësishme (Testimi i Rikthimit të Rezervës) duhet ti delegohet një kompanie të jashtme. g) Te kodohen mediumet e magazinimit në të gjitha pajisjet e korporatave portative që përdoren jashtë mjediseve të Kompanisë. h) Te certifikohet dhoma e serverit dhe / ose qendra e të dhënave në mënyrë që të sigurohet së janë marrë praktikatat me të mira për të minimizuar jo produktivitetin.</p>	Vlerësimi do të bëhet nga një auditim specifik i IT-së në vitet e ardhshme.	Nuk është i aplikueshëm më
9.	Shpenzimet e pagave	Ne rekomandojmë rishikimin e shumës së njohur si një pasuri për paradhëniet ndaj punonjësve dhe rregullimin e vlerës kontabël.	Me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv të datës 28.07.2023 nr 1441 është aprovuar kthimi i paradhënies për të gjithë të punësuarit në KOSTT dhe zbatimi ka filluar që nga muaji gusht 2023	I zbatuar

10.	Shpenzimet e pagave	Ne rekomandojmë që të gjitha këto emërime të rishikohen dhe të behën konform ligjit dhe akteve të brendshme duke ju nënshtruar edhe një herë konkursit të brendshëm. Kompania duhet të sigurojë që të gjitha rastet e promovimeve dhe avancimeve në pozitat e lira të behën përmes konkursit të brendshëm duke respektuar kërkesat e rregullave në fuqi.	Gjatë auditimit 2023 në të gjitha rastet ishin zbatuar kërkesat sipas rregullave në fuqi	I zbatuar
-----	---------------------	--	--	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit



Valbona Pllana, Anëtare e ekipit



Donjeta Rama, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të prokurimit	<p>Nuk pajtohem</p> <p>Procedurat për kontrata me vlerë minimale rregullohen me Nenin 52 të Rregullores së Prokurimit Publik Nr. 01/2022 , përkatësisht paragrafi 52.1 citim: Autoriteti kontraktues mund të përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlere e përlogaritur e të cilës është më pak se 1,000 euro.</p> <p>Departamenti i Prokurimit ka respektuar procedurat e LPP lidhur me zhvillimin e Procedurave minimale konform Nenit 52, me publikimin e tyre përmes platformës së e-prokurimit.</p> <p>Çdo inicim ka kërkesë, arsytim teknik, zotim të mjeteve, dhe specifikim teknik, dhe datë kur është iniciuar. Data e inicimit, tregon që nuk është bërë ndarje, por janë aplikuar blerjet sipas nevojës/rastit, në këtë rast me arsytime faktike, që procedurat e hapura në proces ndërlidhur me ato shërbime, ishin në proces ankimor pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Pjesa dërmuese e këtyre procedurave ndërlidhen me mirëmbajtje të nën-stacioneve, mirëmbajtje të automjeteve dhe makinave speciale dhe furnizime me material të zyrës. Të gjitha këto janë operacione të cilat në mungesë të tyre do të vënin në rrezik serioz funksionimin e nën-stacioneve dhe sigurisë së stafit gjatë kryerjes së punëve.</p>	<p>E gjetura qëndron</p> <p>Komenti i ndërmarrjes është në kundërshtim me gjendjen e përshkruar nga ana jonë në kuadër të kësaj çështje. Në asnjë rast nuk është theksuar se zhvillimi i procedurave të vlerës minimale është bërë në kundërshtim me nenin 48 të rregullores 01/2022.</p> <p>Në çështje është trajtuar zhvillimi i numrit të lartë i procedurave me vlerë minimale duke qenë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit për Prokurimin Publik ku thekson se autoriteti kontraktues nuk do të zgjedh ose përdor metodën e vlerësimit me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 për klasifikimin e kontratës publike sipas vlerës së parashikuar; dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji.</p> <p>Vlen të theksohet që, ndërmarrja gjatë vitit 2023 kishte nënshkruar 67 kontrata përmes procedurës së vlerës minimale.</p> <p>Ndërsa, arsyet e cekura në koment nga ana e ndërmarrjes, lidhur me nevojën e zhvillimit të disa procedurave të tilla, të njëjtat janë të shpalosura edhe në kuadër të çështjes në fjalë në këtë raport.</p>
Aplikimi i kriterëve të përzgjedhjes jo në harmoni me LPP	Neni 68 i Ligjit mbi Prokurimin Publik, i referohet kërkesave kualifikuese ndërlidhur me gjendjen/kapacitetin ekonomik dhe financiar të OE. Në rastet nga	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Në bazë të kërkesave ligjore (neni 68 dhe 69 i LPP-së), në rast se kërkohet lista e kontratave të</p>

<p>Autoriteti kontraktues në njoftime për kontratë kërkon dëshmi mbi qarkullimin financiar, pajtohemi se duhet të vendoset maksimumi prej 2 herë të vlerës së parashikuar, ose në raste kur kërkohet lista e kontratave me vlerë deri 1.5 herë në krahasim me vlerën e parashikuar.</p> <p>Në mostrat e audituara, nuk ishin vendosur kritere kualifikuese tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar (Neni 68).</p> <p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>Referuar Njoftimeve për kontrate të publikuara dhe të bashkëngjitura si dëshmi, asnjëra nga mostrat e audituara nuk përmban Kritere kualifikuese Ekonomike financiare.</p> <p>Lista mostrave të audituara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Furnizimi me Izolator, Elemente Lidhëse, Kleme dhe Koka Kabllovike”; • “Furnizim me Rimorkio për Bartje”; • “Furnizimi dhe Montimi i Gjeneratorit 70 kVA”; • “Furnizimi me Vegla Pune dhe Instrumente”; • “Furnizimi dhe instalimi i baterive industriale pa mirëmbajtje”; • “Furnizimi me Pajisje Mbrojtëse për Nënstacione”; dhe • “Furnizim me Harduer të TIK”. <p>Referuar njoftimeve për kontratë dhe tender dosjes të publikuar sipas listës së mostrave të audituara, vërtetohet lehtë se AK KOSTT gjithmonë ka vendosur kërkesa minimale të mundshme kualifikuese që mundet një AK të vendos, që të mundësohet/që të shtohet numri i ofertuesve, sipas Nenit 69 të LPP-së.</p> <p>Neni 69- Aftësia teknike dhe profesionale</p> <p>1. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj nga operatorët ekonomik të</p>	<p>nënshkruara, aty duhet të precizohet patjetër edhe shuma e kontratave të realizuara.</p> <p>Përveç kësaj, sipas nenit 24 të udhëzuesit nr 01/2023 për prokurim publik tek kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale duhet të kërkohet vlera minimale në lidhje me furnizimet në tri vitet e fundit e cila duhet të dëshmohet me një listë që liston furnizimet kryesore relevante të OE që specifikon: produktet e përfshira, shumën kontraktuale, datën dhe pranuesin / certifikata e pranimit.</p> <p>Pra, kriteri i përcaktuar nga ndërmarrja se paku një kontratë në lidhje me shërbimet e ngjashme në tri vitet e fundit nuk është kriter i matshëm.</p> <p>Lidhur me këtë edhe KKRK ka dhënë interpretim me datë 22.11.2022 ku kishte sqaruar që në rast se autoriteti kontraktues aplikon kërkesën e lartcekur, e rëndësishme është të përmbushet vlera minimale e kërkuar dhe nuk është i rëndësishëm numri i kontratave të realizuara.</p> <p>Tutje, komenti nga ana e ndërmarrjes se shkëputja e mësipërme e Nenit 69.1, cek fjalën mund e jo duhet, si mundësi për Autoritet Kontraktuese gjatë mënyrës së vendosjes së kritereve minimale kualifikuese, është në kundërshtim me gjendjen e përshkruar në kuadër të kësaj çështje.</p> <p>Në asnjë rast nuk është përshkruar nga ana jonë se ky kriter duhet të përcaktohet me patjetër. Ne kemi përshkruar se në rast se ndërmarrja e aplikon kritere të tilla atëherë të njëjtat duhet të aplikohen në harmoni me kërkesat ligjore.</p>
---	--

siguroj dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

iii. shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së):

- Në përputhje me ligjin e prokurimit publik, AK mund të kërkojë nga OE një listë të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi:

1. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë; ose në ndonjë vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të l;shuar ose bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.

2. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimi të tillë.

Kërkesa kualifikuese ndaj OE ndërlidhur me kapacitetin teknik/profesional ishte e prezantimit të 1 kontrate të ngjashme të realizuar brenda 3 viteve të fundit, dhe të dorëzohet si dëshmi e dokumentuar një listë të kontratave me 1 referencë apo certifikatë e pranimi bazuar në listën e kontratave të realizuara. Prezantimi i 1 reference nënkupton vlerën më minimale të numrit të referencave, dhe është minimumi më i mundshëm kualifikues sipas LPP-së.

Shembull nga mostrat:

Se paku 1 kontratë në lidhje me shërbimet e ngjashme në 3 vitet e fundit (për LOT 1) /

Një listë që specifikon parimet

	<p>relevante të performances; shërbimet e ngjashme; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin të dëshmuara me 1 certifikata të pranimi apo i referenca për shërbimet e ngjashme përgjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.</p> <p>Gjithashtu shkëputja e mësipërme e Nenit 69.1, cek fjalën mund e jo duhet, si mundësi për Autoritet Kontratkuese gjatë mënyrës së vendosjes së kritereve minimale kualifikuese.</p>	
<p>Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes</p>	<p>Nuk pajtohem me kualifikim të opinionit</p> <p>Ligji Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditimi në Kapitullin II Kontabiliteti dhe Raportimi Financiar me nenin 4 Raportimi Financiar paragrafi 3 parasheh si në vijim; “ Shoqëritë tregtare me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme zbatojnë SNK-të dhe SNRF-të, SNRF-të për NVM dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KKRF-ja. Tutje neni 7 parasheh “ Zbatimi i standardeve për përgatitjen e pasqyrave financiare për shoqëritë tregtare të mëdha 1. Shoqëritë tregtare të mëdha në Kosovë sipas nenit 5, paragrafët 5 dhe 11, të këtij Ligji zbatojnë SNK-të dhe SNRF-të si dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme të nxjerra nga BSNK-ja, që aprovohen nga KKRF-ja.”</p> <p>Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 16 paragrafi 29 përcakton “ Një njësi ekonomike do të zgjedhë ose modelin e kostos në paragrafin 30 ose modelin e rivlerësimit në paragrafin 31 si politikë kontabël të vet dhe do të zbatojë këtë politikë për të gjitha kategoritë e aktiveve afatgjata materiale.” Rrjedhimisht, referuar paragrafit 29 të SNK 16 rezulton se ri vlerësimi i asetëve nuk është obligative përkundrazi, bazuar në</p>	<p>E gjetura qëndron, bazuar në regjistrin e pasurive, figurojnë 4,467 pasuri me kosto historike 51,751,886€ që janë të zhvlerësuar plotësisht dhe vlera e tyre neto në libra është zero. Për me tepër, në kuadër të pasurive me vlerë neto zero, gjenden 453 pasuri të cilat nuk kishin fare kosto historike në momentin e regjistrimit. Prej tyre 38 toka, 10 ndërtesa, 26 rrugë, 151 pajisje të rrjetit dhe 228 pajisje tjera.</p> <p>SNK 16, Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse:</p> <p>(a) është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe</p> <p>(b) kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri.</p> <p>Marrë parasysh numrin e madh të pasurive të cilat janë të regjistruara me vlerë zero (nuk kanë kosto fare fillestare), atëherë SNK 16, pika 26 Vlera e drejtë e një aktivi për të cilin nuk ekzistojnë transaksione tregu të krahasueshme matet me besueshmëri në qoftë se (a) ndryshimet në gamën e vlerave të drejta të arsyeshme nuk janë të rëndësishme për atë aktiv ose (b) mundësitë e vlerësimeve të ndryshme brenda gamës mund të vlerësohen arsyeshëm dhe të përdoren në vlerësimin e vlerës së</p>

<p>SNK 16 është njëri nga dy opsionet që kompanitë mund të zgjedhin të përdorin në varësi të politikave të tyre të kontabilitetit dhe nevojave të raportimit financiar.</p> <p>Paragrafi 30 i SNK 16 përcakton “Modeli i Kostos: Mbas njohjes fillestare si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar nga zhvlerësimi.” Ky model është më tradicional dhe më i zakonshëm.</p> <p>KOSTT është ndërmarrje publike e rregulluar. Si e tillë, të gjitha të hyrat dhe kostot përcaktohen dhe kontrollohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.</p> <p>Zyra e Rregullatorit të Energjisë për Bazën e Aseteve të Rregulluara përdor Metodën e Kostos e cila është edhe një nga shumë arsyet pse KOSTT është përcaktuar për të njëjtën metodë. Kostot shtesë të zhvlerësimit për pjesën e asetëve të rivlerësuar ZRrE nuk i pranon në Bazën rregullative të asetëve (RAB) dhe nuk njih të hyra për këtë pjesë.</p> <p>Një çështje tjetër ka të bëjë me koston e lartë të shërbimeve të rivlerësimit të pasurive për një ndërmarrje specifike si është KOSTT sh.a. Kostoja e rivlerësimit e cila do të duhej të bëhej nga një kompani e specializuar për rivlerësime për kompani të energjisë siç është KOSTT sh.a.</p> <p>Ky shërbim konsiderohet tejet i kompleks dhe me kosto tejet të lartë . Nëse KOSTT sh.a do të zgjidhte të bëje rivlerësimin dhe të përdorë këtë metodë , rivlerësimi do të duhej të bëhej në baza periodike , duke u përsëritur së paku 3 deri në 5 vite .</p> <p>Një vlerësim i kostove të tregut për shërbimet e rivlerësimit për bazën e pasurive specifike që KOSTT Sh.a ka në pronësi mund të përlllogaritet prej 0.5 deri në 1 milionë euro. Kjo</p>	<p>drejtë. Nëse një njësi ekonomike ka mundësi të përcaktojë me besueshmëri vlerën e drejtë ose të aktivit të marrë ose të aktivit të dhënë, atëherë vlera e drejtë e aktivit të dhënë përdoret për të matur koston e aktivit të marrë përveç rastit kur vlera e drejtë e aktivit të marrë është shumë më e qartë.</p> <p>Gjithashtu sipas paragrafit 51 të SNK 16 vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e asetit duhet të rishikohet të paktën në çdo fund vit. Meqenëse kompania nuk ka ndërmarr veprime me kohë për jetëgjatësinë dhe ato pasuri i përdor atëherë entiteti mund të shqyrtoj rishikimin e metodës së llogaritjes së asetëve dhe të përdorë një metodë tjetër të amortizimit ose vlerësimit që reflekton më mirë gjendjen e tyre aktuale.</p> <p>Madje Ligji Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12 Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve, pika 3 citon që: Nëse për shkak të rrethanave të ndryshme, gjendja fillestare (historike) e pasurisë nuk posedon dokumente burimore ose inventari i pasurive është i panjohur, vlefshmëria e tyre për qëllime të regjistrimit dhe qëllimeve tatimore vlerësohet nga vlerësues të licencuar vendor apo të huaj të pasurive të patundshme për vlerësim dhe regjistrim të pasurive.</p>
---	--

kosto shtesë do të ishte barrë shtesë në faturat e energjisë elektrike tek konsumatori fundor.

Bazuar në çka u prezantua me lartë, KOSTT në Politikat kontabël e ka të përcaktuar Modelin e Kostos (Kostoja historike), si metoda më e përshtatshme dhe e favorshme si për kompaninë ashtu edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sipas vlerësimit të menaxhmentit pasi të rregullohet çështja e pronësisë (tokave) do të rivlerësojë këtë kategori sipas kërkesave të SNK 16.

<p>Dobësi në vlerësimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit</p>	<p>Nuk pajtohem i Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në udhëzimet për OE apo interpretimet ligjore e lejon përjashtimin e OE nga konkurrimi, vetëm kur OE në fjalë oferton me një tërësi ofertë individualisht e me një tërësi ofertë si anëtar i grupit/konzorciumit për të njëjtën procedurë të prokurimit.</p> <p>Çertifikata e biznesit, së bashku me veprimtarinë primare dhe sekondare është vlerësuar vetëm si dëshmi e dokumentuar në kontekst të pajtueshmërisë konform neneve 54, 56 dhe 59 të LPP-së.</p> <p>Verifikimet apo analiza e pronësisë, përderisa nuk ceket tek kriteri kualifikues, nuk do jepte një rezultat ndryshe gjatë një procesi të vlerësimit, sepse nuk ka bazë ligjore, apo interpretim ligjor nga KRPP, sepse përderisa edhe KRPP, gjatë regjistrimit të OE dhe pastaj edhe gjatë procesit të tenderimit nuk e ndalon/kufizon një situatë/ofertim të tillë .</p> <p>Përderisa krejt këto fazat e mësipërme janë konsumuar, AK KOSTT nuk mund të veprojnë ndryshe, përveç të respektoj Nenin 7 dhe, Nenin 54, Nenin 56 dhe Nenin 59 gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, dhe një arsye që përmendet nga auditorët në raport ta cekim si arsye për eliminim, sepse s'ka bazë ligjore kufizuese.</p> <p>Mospërfillja e ligjeve tjera ndërlidhëse, bie në përgjegjësi të OE (dhe në shumës), dhe Riskut që ato marrin në bazë të Nenin 65 ku fillimisht dorëzojnë Deklaratën nën Betim.</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Në bazë rregullore nr. 001/2022 për Prokurim Publik operatori ekonomik nuk lejohet të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e dy operatoreve ekonomik me pronarin e njëjtë të biznesit në të njëjtën procedurë të prokurimit dëmton konkurrencën/krijon konkurrencë të pa ndershme.</p> <p>Lidhur me komentin nga ana e ndërmarrjes që KRPP, gjatë regjistrimit të OE dhe pastaj edhe gjatë procesit të tenderimit nuk e ndalon/kufizon një situatë/ofertim të tillë, kjo nuk do të thotë se rrjedhimisht ju lejohet që pronaret që kanë në emrin e tyre me shumë se një biznes të aplikojnë në procedurën e njëjtë të prokurimit.</p>
<p>Mos pagesa e obligimeve ndaj furnitorëve</p>	<p>Nuk pajtohem i Paranë e mbajtur sipas LPP-ës, Kontraktori mund të e tërheq në dy mënyra si në udhëzimin në vazhdim, me kërkesë (nënkuptohet), sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës:</p> <p>Mbajtja e Parasë</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Kushti i parasë së mbajtur është vendosur nga ndërmarrja tek Kushtet e Veçanta të Kontratës. Tek kjo pjesë nuk është fare e precizuar se Operatori Ekonomik duhet të bëjë kërkesë me shkrim pasi të kalon perioda e defekteve për pagesën e</p>

<p>a) Shuma, e specifikuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës, do të ndalohet nga çdo pagesë e Furnizuesit deri në përfundim e Projektit.</p> <p>b) Me lëshimin e Certifikatës/Dokumentit mbi Përfundimin e Projektit nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet furnizuesit kur të kaloj periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Furnizuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar.</p> <p>Furnizuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar apo me garancion nga kompanitë e sigurimit “me kërkesë”.</p> <p>Pasi që Paraja e mbajtur është në interes primar të Kontraktorit të kërkohet si pagesë me një kërkesë formale zyrtare me e-mail apo tjetër, me të cilën kërkesë njëkohësisht Kontraktori deklaron/siguron Projekt Menaxherin se nuk kishte defekte gjatë periudhës garantuese apo periudhës së përgjegjësisë së defekteve.</p> <p>Departamenti i Prokurimit konfirmon së një kërkesë e tillë zyrtare nuk është dorëzuar nga Kontraktori, apo Kontraktorët për kontratat/mostrat e audituara, për lirim të parasë së mbajtur.</p> <p>Çdo pagesë e parasë së mbajtur, bëhet me Raport mbi pranimin e aktiviteteteve të realizuara nga Menaxheri i Projektit, dhe në mungesë të kërkesës nga Kontraktori (e cila dorëzohet si dëshmi komplementare për pagesë ndër të tjera) pagesa nuk ka mundur të realizohet.</p> <p>Sipas KVK, Kjo është e vetmja rrugë e komunikimit zyrtar ndërlidhur me pagesat, në këto raste edhe për pagesën e Parasë së mbajtur.</p> <p>Këtë rrugë komunikuese/aprovuese për disbursim të pagesës së parasë mbajtur, Kontraktori apo Kontraktorët</p>	<p>pjesës së mbajtur nga ndërmarrja.</p> <p>Edhe në komentit e cekur nga vet autoriteti theksohet qartë se tek kushtet e veçanta është precizuar që me lëshimin e Certifikatës/Dokumentit mbi Përfundimin e Projektit nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet furnizuesit kur të kaloj periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Furnizuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar.</p> <p>Ndërsa në rast se furnizuesi dëshiron të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar apo me garancion nga kompanitë e sigurimit atëherë kjo gjë duhet të behet “me kërkesë”.</p> <p>Tutje, në kuadër të kushteve të përgjithshme tek kontratat për furnizime, specifikohet që certifikata finale e pranimit lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditëve nga skadimi i periudhës se garancisë ose menjëherë pas riparimeve eventuale që janë kërkuar. Ndërsa, tek kontratat për punë tek kushtet e përgjithshme të kontratës specifikohet që shuma e mbajtur ose garancia e mbajtur do të paguhet brenda 30 ditëve nga lëshimi i deklaratës së llogarisë përfundimtare.</p> <p>Përveç kësaj, tek kushtet e veçanta të kontratave të cekura në kuadër të kësaj çështje, ishte precizuar që asnjë faturë nuk do të dorëzohet për pagese pa u harmonizuar në mënyrë elektronike (email) me projekt menaxherin dhe zyrtarin e prokurimit se fatura është në rregull dhe se furnizimet janë pranuar.</p> <p>Bazuar në këtë, në mënyrë të çartë është kërkuar që në rastin e realizimit të pagesave është kërkuar komunikimi me email në mes zyrtareve të ndërmarrjes. Pra në asnjë pjesë të kontratës nuk është</p>
---	---

	<p>në fjalë e kanë aplikuar në projektet tjera.</p> <p>Neglizhenca e kontraktorit, nuk mund t'i atribuohet Autoritetit Kontraktues.</p>	<p>kërkuar që për realizimin e pagesave të mbajtura nga autoriteti kontraktues duhet që fillimisht të ketë një kërkesë me shkrim nga operatori ekonomik siç është pretenduar nga ndërmarrja në bazë të komentit të dhënë.</p> <p>Nëse operatori ekonomik i ka përmbushur të gjitha kushtet e cekura në kontratë atëherë edhe ndërmarrja do të duhej ti zbatonte pagesat në bazë të kushteve të kontratës.</p> <p>Si përfundim, komenti i dhënë nga ana e ndërmarrjes lidhur me këtë çështje, është në kundërshtim të plotë me kërkesat e vendosura në kushtet e veçanta të kontratës nga vet ndërmarrja.</p>
<p>Nënshkrimi i kontratës për auditimin e Pasqyrave Financiare</p>	<p>Kjo çështje është diskutuar në takimin fillestar ndërmjet Kryeshefit Ekzekutiv, Ndhmës Auditorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Auditimit dhe Ekipit auditues. Kryeshefi i ka njoftuar në takimin fillestar se KOSTT është në proces të prokurimit për shërbimet e auditimit të jashtëm. Kjo për arsye se</p> <p>1. Zyra Kombëtare e Auditimit në njoftimin e saj dhe në diskutim ka treguar që për vitin 2023 nuk kryen auditime për qëllime të veçanta për KOSTT, pra auditimi i pasqyrave për nevoja të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.</p> <p>2. Nënshkrimi i kontratës për auditimin e Pasqyrave Financiare është realizuar për dy raporte:</p> <p>a. Raportin e auditimit për pasqyra financiare vjetore sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, në bazë të cilit parashihen afatet e caktuara kohore për dorëzim të pasqyrave financiare të audituara në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.</p> <p>b. Po ashtu sipas këtij ligji parashihet</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Zyra Kombëtare e Auditimit e kishte njoftuar KOSTT me datën 18.09.2024 për planin e auditimit ku KOSTT do të jetë subjekt i auditimit të PFV për vitin 2023.</p> <p>Këtë e kishte bërë sipas Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 18, pika 4, ku citon: Zyra Kombëtare e Auditimit mund të kryej auditime të detyrueshme të rregullsisë në Ndërmarrjet Publike. Auditori i Përgjithshëm informon Aksionarin më së voni me 30 shtator të vitit aktual mbi atë se cilat nga këto auditime do të kryhen.</p> <p>Edhe përkundër njoftimit zyrtar të ZKA-së për fillimin e procesit të auditimit, KOSTT me datën 29.09.2023 kishte bërë njoftimin për kontratë edhe pa mbajtur fare takimin me ekipin e Zyrës Kombëtare të Auditimit.</p> <p>Tutje, në takimin fillestar të mbajtur me datën 23.10.2024 nga ZKA dhe menaxhmenti i KOSTT-it është njoftuar prapë që auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023</p>

<p>afati ligjor për dërgim tek Agjencia e Statistikave të Kosovës pasqyrën e pozitës financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informatat shtesë lidhur me vitin paraardhës kalendarik për qëllime statistikore dhe qëllime të tjera.</p> <p>c. Raportin e auditimit të pasqyrave financiare vjetore për qëllime të veçanta sipas udhëzimeve rregullatore të kontabilitetit ZRrE.</p> <p>d. Këto raporte janë të ndërlidhura dhe auditimi i vetëm njërit raport nga auditori i pavarur do të kishte të ngashme sepse koha dhe të gjitha procedurat e njëjta përdoren nga auditorët e pavarur për dhënjen e opinioneve për të dy raportet.</p> <p>Angazhimi i Kompanisë audituese ka qenë e nevojshme për shkak:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ofronte auditim të Raportit për qëllime të veçanta sipas kërkesës nga ZRrE për vitin 2023. - Afatit ligjor deri më 30 prill të vitit vijues për dorëzim të pasqyrave financiare të audituara dhe raportimet shtesë në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. (Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim) - Në rast të mos dërgimit të dokumentacionit të kërkuar apo dërgimit me vonesë në KKRF, me ligj parashihen të drejtat për shqiptimin e masave ndëshkimore në varësi të klasifikimit të ndërmarrjes. (Ligji Nr. 06/L-032, Neni 36). - Dispozitave specifike nga nga Marrëveshja për Kredi me BERZH e vitit 201,4 e cila kërkon nga KOSTT angazhimin e një firme ligjore të pavarur. 	<p>do të bëhet nga ZKA.</p> <p>Pavarësisht kësaj, KOSTT kishte nënshkruar kontratën me datën 12.12.2023 për dy raportet e auditimit përfshirë atë të pasqyrave financiare të cilin veçse e kishte filluar ZKA-ja.</p> <p>Lidhur me komentin e KOSTT ku thotë që, Angazhimi i Kompanisë audituese ka qenë e nevojshme për shkak: Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ofronte auditim të Raportit për qëllime të veçanta sipas kërkesës nga ZRrE për vitin 2023, komenti si i tillë nuk qëndron për faktin që KOSTT kishte mundësinë të fillonte procesin e tenderimit vetëm për kontraktimin e auditimit për nevoja të veçanta.</p>
--	---

<p>Tejkalimi i vlerës totale të kategorisë sipas kontratës</p>	<p>Procedura e prokurimit publikuar/kontraktuar në vitin 2020, më herët se kur është dhënë interpretimi ligjor nga KRPP, i cili ishte në qershor të vitit 2023, dhe para hyrjes në fuqi të Rregullores së Prokurimit Nr.01/2022 me dt. 01.11.2022.</p> <p>Kjo e gjetur, gjithashtu nuk është e bazuar as në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ të vitit 2019 dhe atë të vitit 2021. Mënyra e publikimit të Kontratave kornizë me kategorizim ishin të saktësuar/rregulluar me Nenin 56.15.</p> <p>Kontratat kornizë me kategorizim, sipas Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të viteve 2019 dhe 2021, janë aplikuar për Kontratat kornizë ku ishte e pamundur përcaktimi i sasisë.</p> <p>Një Kufizim i vlerës totale të realizimit të kategorisë është vendosur tani në Rregulloren e Prokurimit Nr.01/2022, e cila aktualisht është në fuqi.</p> <p>Këto janë fakte të patejkalueshme, dhe konsiderojmë që duhet të përmendet edhe në draft raportin final, dhe si e gjetur të largohet në tërësi në raportin final, sepse nuk është e bazuar në Nenet e rregulloreve apo udhëzuesve të cilit ishin në fuqi para datës së publikimit/nënshkrimit të kontratës kornizë në fjalë.</p>	<p>E gjetura qëndron.</p> <p>Edhe përkundër komentit të autoritetit kontraktues e gjetura qëndron për faktin se edhe në kuadër të rregullave dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik të viti 2019 dhe 2021 (tani të shfuqizuar) edhe në kuadër të të rregullores 001/2022 për prokurim publik që është në fuqi, përmbajtja e kriterit është e njëjtë.</p> <p>Edhe në bazë të udhëzimeve të shfuqizuara është kërkuar që kurdoherë që Autoriteti Kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.</p> <p>Pra, arsyeja e përcaktimit të peshimit është përcaktimi i çmimit me të lirë në bazë të asaj se si autoriteti kontraktues i përcakton kategoritë. Në bazë të atyre kategorive tutje duhet të behet edhe realizimi i kontratës. Pra, kërkesat ligjore kanë mbetur të njëjta dhe interpretimi i KKRPs-së në vitin 2023 vetëm ka dhënë sqarime me të hollësishme lidhur me këtë kërkesë.</p>
--	---	---

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA KOSTT d.d
 Nr. 1597 Dt. 25.06.2024
 PRISHTINE-A

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E SHËNDRIMIT TË TËNDRITËS DATE OF REVISION OF THE STATEMENT			
25-06-2024			
Mimesa Orig. Orig. Unit	Shif. Klasif. Class. Code	Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	955	10

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZISTA A.D



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të KOSTT sh.a, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohemi pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment shtesë përveç atyre të pasqyruara në shtojcën e komenteve për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzohet një plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


 Z. Jeton Mehmeti
 Kryesues i Bordit të KOSTT sh.a
 Data: 25 qershor.2024, Prishtinë,



Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ³ Vlen të ceket se bartje të pasurive nga KEK në KOSTT kishin ndodhur edhe përgjatë viteve 2012-2013.

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d

Nr. 940 Dt. 18 04 2024
PRISHTINË- A

PASQYRAT FINANCIARE

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU - KOSTT SH.A

31 DHJETOR 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet për pasqyrat financiare	7

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
MË 31 DHJETOR 2023**

		31 dhjetor 2023 EUR'000	31 dhjetor 2022 EUR'000
PASURITË			
PASURITË AFATGJATA			
Prona, impiantet dhe paisjet	4	122,384	132,900
Pasuritë e paprekshme	5	275	407
Investimet në shoqëri	6	362	617
Investimet financiare	7	40	40
GJITHSEJ PASURITË AFATGJATA		123,061	133,964
PASURITË AFATSHKURTËRA			
Stoqet	8	4,595	4,407
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	61,296	84,101
Tatimi i arkëtueshem mbi të ardhurat e korporatave		32	59
Depozitat me afat	10	4,800	4,800
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	11	26,747	67,273
GJITHSEJ PASURITË AFATSHKURTËRA		97,470	160,641
GJITHSEJ PASURITË		220,531	294,605
EKUITETI DHE DETYRIMET			
EKUITETI			
Kapitali aksionar	12	25	25
Rezervat e transferimit	13	53,377	53,377
Fitimet e mbajtura		30,127	47,233
GJITHSEJ EKUITETI		83,529	100,635
DETYRIMET			
DETYRIMET AFATGJATE			
Grantet e shtyra	14	36,850	43,034
Detyrimet e shtyera tatimore	25	6,380	6,539
Huatë	15	21,309	26,583
GJITHSEJ DETYRIMET AFATGJATE		64,539	76,156
DETYRIMET AFATSHKURTËRA			
Huatë	15	5,145	32,457
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	16	67,318	85,356
GJITHËSEJ DETYRIMET AFATSHKURTËRA		72,463	117,813
GJITHSEJ DETYRIMET		137,002	193,969
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		220,531	294,605

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë më 8 prill 2024 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga :

Evetar Zeqiri
Kryeshef ekzekutiv




Nebih Haziri
Zyrtar kryesor financiar

**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2023**

	Shënimet	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Shitjet	17	36,800	34,720
Të ardhurat e tjera	18	9,141	16,189
Shpenzimet/Të ardhurat nga burimet e energjisë së ripërtëtitshme, neto	19	(5,131)	1,236
GJITHSEJ TË ARDHURAT		40,810	52,145
Të ardhura të tjera nga grantet	20	18,193	64,049
Lirimi/(ngarkesa) për provizionim të llogarive të arkëtueshme	9	2,276	(3,012)
Humbja e energjisë	21	(35,731)	(78,067)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(14,817)	(15,538)
Shpenzimet tjera operative	22	(21,253)	(12,499)
Shpenzimet e personelit	23	(5,258)	(5,345)
Riparimi dhe mirëmbajtja	24	(506)	(606)
FITIMI(HUMBJA)NGA OPERACIONET		(16,286)	1,127
Të ardhurat financiare	25	889	1,845
Shpenzimet financiare		(1,612)	(1,456)
Shpenzimet financiare/Të ardhurat		(723)	389
Pjesa e fitimi/humbjes në shoqëri	6	(255)	(251)
FITIMI(HUMBJA) PARA TATIMIT		(17,264)	1,265
Shpenzimet e tatimit në fitim	26	159	(471)
FITIMI(HUMBJA) PËR VITIN		(17,105)	794
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Te ardhurat nga ndryshimet ne rezerva		-	9
GJITHSEJ TË ARDHURAT(HUMBJA) GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		(17,105)	803

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2023

	Kapitali aksionar EUR '000	Rezervat e rivlerësimit EUR '000	Fitimet e mbajtura EUR '000	Gjithësej EUR '000
MË 01 JANAR 2023	25	53,377	47,234	100,635
Transaksioni me pronarin				
Dividenda e paguar gjatë vitit	-	-	-	-
Gjithësej transaksionet me pronarin	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	(17,105)	(17,105)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	-	-	(17,105)	(17,105)
MË 31 DHJETOR 2023	25	53,377	30,128	83,530
MË 01 JANAR 2022	25	53,367	46,440	99,832
Transaksioni me pronarin				
Dividenda e paguar gjatë vitit	-	-	-	-
Gjithësej transaksionet me pronarin	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	794	794
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	9	-	9
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	-	9	794	803
MË 31 DHJETOR 2022	25	53,377	47,234	100,635

**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2023**

		EUR'000	EUR'000
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi/(humbja) para tatimit		(17,264)	1,265
Rregulluar për:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	14,817	15,538
Të ardhurat nga interesi		(889)	(1,845)
Shpenzimet e interesit		1,612	1,456
Provizionet dhe detyrimet tjera		197	251
Provizionet për llogari të arkëtueshme		(2,276)	3,012
Të shlyera - jashtë përdorimi		26	22
Dëmtimi i investimeve në shoqëri		255	251
Të ardhurat e shtyra nga grantet		(18,193)	(64,049)
<i>Të ardhurat(humbja) operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues</i>		(21,715)	(44,099)
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:			
Stoqet		(188)	41
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		24,485	(5,387)
Detyrimet tregtare dhe të tjera		(16,621)	(4,352)
Fitimi/(humbja) nga operacionet pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues		(14,040)	(53,797)
Tatimi mbi fitimin (I paguar)		(42)	(59)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(14,082)	(53,857)
AKTIVITETET INVESTUESE			
Interesi i arkëtuar		68	279
Pagesë për investimet në shoqëri		-	-
(Blerja) e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme		(4,195)	(3,069)
Pagesë e depozitave me afat/Arketim		-	12,000
Dividendë e pranuar		-	-
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investive		(4,126)	9,210
AKTIVITETET FINANCUESE			
Interesi (i paguar)		(1,612)	(1,456)
Pagesë e huazimeve		(32,585)	(6,014)
Huatë e pranuar		-	26,441
Të ardhurat nga Grantet		11,880	57,500
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(22,317)	76,471
NDRYSHIMI NETO NË PARA DHE EKVIVALENTËT E PARASË		(40,526)	31,823
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim		67,273	35,450
PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË NË FUND	11	26,747	67,273

SHËNIMET

	Faqe
1 Informata të përgjithshme	8
2 Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme	8
3 Gjykime të rëndësishme dhe burime kyçe të të pasigurisë në vlerësim	19
4 Prona, impiantet dhe pajisjet	20
5 Pasuritë e paprekshme	22
6 Investimet në shoqëri	22
7 Investimet financiare	23
8 Stoqet	24
9 Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	24
10 Depozitat me afat	25
11 Paraja dhe ekuivalentet e parasë	25
12 Kapitali aksionar	25
13 Rezerva e transferit	25
14 Grantet e Shtyra	26
15 Huatë	27
16 Detyrimet tregtare dhe të tjera	28
17 Të ardhurat	29
18 Të ardhurat e tjera operative	29
19 Të ardhurat/Shpenzimet nga burimet e ripërtëritshme të energjisë	29
20 Të ardhurat tjera nga Grantet	29
21 Humbja e Energjisë	30
22 Shpenzimet e tjera operative	30
23 Shpenzimet e personelit	30
24 Riparimet dhe Mirëmbajtjet	31
25 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	31
26 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	31
27 Instrumente Financiare sipas kategorive	32
28 Matja e vlerës së drejtë	33
29 Informacion mbi rreziqet financiare	34
30 Menaxhimi i riskut kapital	37
31 Palët e lidhura	37
32 Zotimet dhe kontingjencat	38
33 Ngjarjet pas datës raportuese	38

SHËNIME PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2023

1 INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Operator Sistemit Transmisioni dhe Tregut (këtu e tutje "Kompania" ose "KOSTT Sh.A") u themelua si një entitet i pavarur më 23 dhjetor 2005 nga transformimi i Korporata Energjetike e Kosovës ("KEK") dhe u regjistrua si një kompani aksionare Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/6 e datës 8 Shkurt 2001 mbi Organizatat e Biznesit ("Rregullorja") me numrin e regjistrimit të biznesit 70325350. Kompania filloi punën e saj në mënyrë të pavarur nga 1 korriku 2006 sipas marrëveshjes midis KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A. në lidhje me marrëdhënien kalimtare, tregtare dhe operacionale midis KEK SH.A dhe KOSTT SH.A mbi transferimin e përgjegjësisë për operacionet dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Transmetimit të KOSTT SH.A. Adresa e zyrës së regjistruar të Kompanisë është "Ndërtesa e Transmisionit dhe Dispečimit, Isa Boletini Nr. 39, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Në përputhje me Ligjin Nr. 03 / L-087 të datës 13 Qershor 2008 mbi "Ligjin për Ndërmarrjet Publike", Sistemi i Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A. është pronë e Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë menaxhimi dhe funksionimi i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë dhe janë përgjegjës për transmetimin e energjisë elektrike në rrjetet kryesore elektrike të tensionit të lartë. Si një operator i tregut Kompania është gjithashtu përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e tregtisë në energji elektrike dhe menaxhon procesin e zgjidhjes. Më 31 Dhjetor 2023 Kompania ka 345 punonjës (2022: 348)

2 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare janë dhënë më poshtë.

2.1 BAZA E PËRGADITJES DHE DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), duke qenë standarde dhe interpretime të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNEK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF-të për secilin lloj të pasurisë, detyrimit, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më plotësisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kritike të kontabilitetit. Ai gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në Shënimin 3: Gjykimi i rëndësishëm dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur më dhe për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të shprehura në këto pasqyra financiare shprehen në mijëra Euro, përveç nëse përcaktohet ndryshe. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'u përshtatur me ndryshimet në prezantim për vitin.

Pasqyrat financiare paraqiten në Euro ("EUR"), e cila është monedha prezantuese dhe funksionale e Kompanisë.

2.2 PARIMI VIJIMËSISË

Gjatë vitit financiar aktual, Kompania ka raportuar një humbje prej 17,102 mijë euro krahasuar me një fitim prej 794 mijë euro në vitin paraprak. Kjo humbje ka ardhur si pasojë e mos mbulimit të konsumit në pjesën veriore të Kosovës. Në humbjen operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë përfshirë shpenzimet për energjinë në komunat veriore të Republikës së Kosovës në vlerë prej 26,789 mijë euro (31 dhjetor 2022: 63,177 mijë euro). Këto shpenzime nuk janë shpenzime të kompanisë në rrjedhën normale të operimit, megjithatë kompania ka qene e obliguar t'i paguajë në bazë të Ligjit 05/L-081 për energjinë elektrike dhe licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në bazë të së cilës kompania është përgjegjëse për balancimin e sistemit energjetik. Gjatë vitit 2023, qeveria ka dhënë grante në vlerë prej 11,880 mijë euro, e cila mbuloi një pjesë të humbjeve të shkaktuara të energjisë në komunat veriore. Menaxhmenti e ka ngritur këtë çështje në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës dhe aktualisht është në pritje të një vendimi për kompenzimin e kostove të pa mbuluara për pjesën veriore të Kosovës.

Nga janari i vitit 2024 obligimin për furnizimin me energji për pjesën veriore të Kosovës e ka kompania Elektroserver dhe KOSTT është liruar nga ky obligim sipas vendimit të ZRrE.

Menaxhmenti po monitoron nga afër këta faktorë të mësipërm dhe do të vazhdojë të zbatojë masat e duhura për të zbutur ndikimin e tyre të mundshëm në operacionet dhe performancën financiare të Kompanisë.

Bazuar në performancën aktuale financiare të Kompanisë dhe veprimet e ndërmarra nga drejtimi për të ruajtur supozimin e vazhdimësisë, menaxhmenti beson se është e përshtatshme të përgatiten pasqyrat financiare mbi bazën e vijimësisë.

2.3 STANDARDET E REJA APO TË NDRYSHUARA KONTABËL DHE INTERPRETIMET E ADOPTUARA

a) Standardet, interpretimet dhe ndryshimet e reja të miratuara nga 1 janari 2023

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat janë efektive për periudhën raportuese:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit.
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit: Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 - Informacion krahasues.
- Ndryshimet në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNRF Deklarata e Praktikës 2: Shpalosja e Politikave të Kontabilitetit.
- Ndryshimet në Politikat e Kontabilitetit të SNK 8, ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit dhe gabimet: Përkufizimi i vlerësimeve të kontabilitetit.
- Ndryshimet në SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm.
- Ndryshimet në SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat: Reforma ndërkombëtare e tatimeve - Shtylla Dy-Rregullat e modelit.

Ndryshimet dhe standardet e tjera të përmendura më sipër nuk kanë ndikim domethënës që aplikohen në Kompani përveq SNK 1 Shpalosjes së politikave të kontabilitetit që është adaptuar në pasqyra financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023.

Reforma e Referencës së Normës së Interesit - 'faza 2' e IBOR (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF

Këto ndryshime në standardet e ndryshme të SNRF janë efektive të detyrueshme për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, megjithatë, Kompania i ka miratuar ato para hyrjes në fuqi të tyre. Këto ndryshime modifikojnë kërkesat specifike të kontabilitetit mbrojtës për të lejuar kontabilitetin mbrojtës të vazhdojë për mbrojtjet e prekura gjatë periudhës së pasigurisë përpara se elementët e mbrojtur ose instrumentet mbrojtës të prekur nga referencat aktuale të normave të interesit të ndryshohen si rezultat i reformave në vazhdim të referencës së normës së interesit. Ndryshimet nuk janë relevante për Kompaninë duke pasur parasysh se ajo nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës për ekspozimet e tij standarde të normave të interesit.

b) Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Ekzistojnë një numër standardesh, ndryshime në standarde dhe interpretime të cilat janë publikuar nga BSNK por ende nuk janë efektive për periudhën e raportimit dhe si të tilla nuk janë aplikuar akoma nga Kompania.

Ndryshimet e mëposhtme janë efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2024:

- IAS 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Amendamente në lidhje me klasifikimin e detyrimeve, amendament për shtyrjen e datës efektive të amendamenteve të janarit 2020, amendamente në lidhje me klasifikimin e borxheve me konventa), efektive nga 1 janar 2024.
- IFRS 7 Instrumente Financiare: Shpalosjet (Amendamente në lidhje me marrëdhëniet e financimit të furnizuesit), efektive nga 1 janar 2024.
- IFRS 16 Qiratë (Amendamente për të sqaruar se si një shitës-qiradhënës më pas mat shitjet dhe kthimet e transaksioneve të qirave), efektive nga 1 janar 2024.
- IAS 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parave (Amendamente në lidhje me marrëdhëniet e financimit të furnizuesit), efektive nga 1 janar 2024.
- IFRS S1 Kërkesat e Përgjithshme për Shpalosjes së Informacionit Financiar lidhur me Qëndrueshmërinë, efektive nga 1 janar 2024.
- IFRS S2 Shpalosjet lidhur me Klimën, efektive nga 1 janar 2024.

2.4 NJOHJA E TË ARDHURAVE

E hyra nga shitja njihet në shumën që reflekton vlerësimin për të cilën kompania pritet të jetë e thirrur në shkëmbimin e të mirave apo shërbimeve të klientit. Për çdo kontratë me klient, kompania: identifikon kontratën me klientin; identifikon obligimet në kontratë; përcakton çmimin e transaksionit që merr në llogari vlerësimet e ndryshme dhe vlerën në kohë të parasë; alokon çmimin e transaksionit për detyrimet e veçanta në bazë të çmimit të shitjes së pavarur të çdo malli apo shërbimi që do të dërgohet; dhe njeh të hyrat kur ose secili obligim është përfunduar në një mënyrë që përshkruan transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara.

Vlerësimet e ndryshme brenda çmimit të transaksionit, nëse ka, reflektojnë koncesionet të siguruara të klientit siç janë zbritjet, rabatet dhe rimbursimet, çdo bonus potencial i arkëtueshëm nga klienti dhe çdo ngjarje tjetër kontingjente. Vlerësimet e tilla përcaktohen duke përdorur ose metodën e 'vlerës së pritur' ose metodën e 'vlerës më të mundshme për të ndodhur'. Matja e vlerësimeve të ndryshme i nënshtrohet një parimi kufizues prej ku shitja do të njihet vetëm deri në shkallën që është shumë e mundshme që një kthim domethënës në vlerën e grumbulluar të shitjes nuk do të ndodhë. Vlerësimi i kufizuar vazhdon derisa pasiguria e shoqëruar me vlerësimin e ndryshëm zgjidhet më pas. Shumat e pranuar që i nënshtrohen parimit të kufizuar njihen fillimisht si të hyra të shtyra në formë të një detyrimi të ndarë rimbursues.

Të ardhurat nga Sistemi i Transmisionit

Të ardhurat nga Sistemi i Transmisionit janë të ardhura nga tarifat për transmetimin e energjisë përmes rrjetit të transmisionit. Të ardhurat nga operatori i sistemit janë kryesisht të ardhura me Kompanin e Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës (KESCO). Tarifat e ngarkuara janë për shërbimet e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të transmetimit të energjisë elektrike.

Të ardhurat nga Operatori i Sistemit

Të ardhurat nga Operatori i Sistemit janë të ardhurat nga tarifat të cilat gjenerohen për funksionimin e sistemit. Të ardhurat atje janë kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe KESCO. Tarifat tarifohen për operacione efikase të rrjetit, përfshirë rrjetin ndërkombëtar.

Të ardhurat nga Operatori i Tregut

Të ardhurat nga Operatori i Tregut janë të ardhurat e gjeneruara nga funksionimi i tregut në përputhje me ligjin për energjinë dhe gjithashtu nga shërbimet nga administrimi i tregut të centralizuar të energjisë elektrike në Kosovë. Të hyrat përfshijnë gjithashtu shërbimet për balancimin e bilanceve jo-energjetike.

Të ardhurat nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE)

Ligji për Energjinë Elektrike LIGJI Nr. 05 / L - 085 ndër të tjera detyron Operatorin e Tregut për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE. Në këtë kontekst, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka miratuar Rregulloren për Skemën e Mbështetjes, e cila përcakton që Gjeneruesit e BRE-ve të pranuar në Skemën e Mbështetjes ose nën Kornizën e Rregulluar kanë të drejtë të shesin gjenerimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut, përmes Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë

Interesi

E hyra nga interesi njihen kur interesi ndodh duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo është një metodë e kalkulimit të kostos së amortizuar së një pasurie financiare dhe e alokimit të hyrave të interesit nëpër periudhën relevante duke përdorur normën e interesit efektiv, normë e cila saktësisht zbrit pranimet e keshit të parashikuara përmes pritshmërisë së pasurisë financiare për vlerën neto kontabël të pasurisë financiare.

Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera njihen kur pranohen ose kur përcaktohet e drejta për të marrë pagesa.

2.5 SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet e operimit njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën e origjines.

2.6 HUMBJET E ENERGJISË

Humbja në transmisionin e energjisë njihet në kohën e ndodhjes dhe llogaritet në bazë mujore. Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit paraqiten si një ndryshim midis energjisë elektrike të matur në hyrjen e rrjetit të transmisionit dhe energjisë së matur në daljen e rrjetit të transmisionit. Diferenca llogaritet në baza mujore. Bazuar në diferencën e matur, humbjet faturohen dhe kompania është përgjegjëse për kompensimin e shumave të faturuara.

2.7 KLASIFIKIMI AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË

Pasuritë dhe detyrimet janë të paraqitura në pasqyrën e pozitës financiare duke u bazuar në klasifikimin afatshkurtë dhe afatgjatë.

Një pasuri klasifikohet si afatshkurtë kur: ose pritjet të realizohet prej saj ose qëllimi është për t'u shitur ose

brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose pasuria është kesh apo ekuivalent i keshit përveç nëse ndalohet për t'u këmbyer apo për t'u përdorur për kryerjen e një detyrimi për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha pasuritë tjera klasifikohen si afatgjatë.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtë kur: ose pritet të kryhet në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritet të kryhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për ta shtyrë kryerjen e detyrimit për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet tjera klasifikohen si afatgjatë.

Tatimi i shtyrë si pasuri dhe detyrime gjithnjë klasifikohet si afatgjatë.

2.8 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

Zërat e ndërtesave, impianteve dhe paisjeve më 1 Janar 2006 janë rideklaruar me koston e konsideruar minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar, ndërsa zërat e ndërtesave pronave dhe paisjeve të blera pas 1 janarit 2006 deklarohen me kosto minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

Kostoja e konsideruar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga një konsulent i pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare më 1 Janar 2005. Këto pasuri njihen si një kontribut transfer i pasurive nga KEK SH.A. në data e korporatës (Shënim 13).

Shuma e mbajtur për secilin komponent të llogaritur për, si pasuri e ndarë nuk njihet kur zëvendësohet. Të gjitha rregullimet dhe mirëmbajtjet janë të ngarkuara me fitim apo humbje gjatë periudhës së raportimit në të cilën ata janë shkaktuar.

Rritja në vlerën kontabel që rrjedh nga rivlerësimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve janë të regjistruara, neto nga taksat, në të hyra të tjera gjithëpërfshirëse dhe të rezervave të akumuluar të ekuitetit të aksionarëve. Deri në pikën ku rritja kthehet në rënie më parë e njohur si humbje ose fitim, rritja fillimisht është njohur si fitim apo humbje. Rënie që kthejnë rritjen e mëparshme të pasurisë të njëjtë njihen fillimisht në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në pikën e shtesës së mbetur të atribueshme për pasurinë; të gjitha rënie të tjera janë të ngarkuara në humbje ose fitim. Çdo vit, dallimi mes zhvlerësimit të bazuar në shumën kontabel të rivlerësuar të pasurisë të ngarkuar me fitim apo humbje dhe zhvlerësimit të bazuar në çmimin origjinal të pasurisë, neto nga tatimi, riklasifikohet nga shtesa e rivlerësimit të fitimit të shpërndarë të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e pasurive rishikohen, dhe rregullohen nëse janë të përshtatshme, në fund të secilës periudhë të raportimit.

Shuma e mbajtur e një akti regjistrohet menjëherë tek shuma e rimarr nëse shuma e bartur e pasurisë është më e madhe se shuma e njehsuar e rimarrë.

Fitimet dhe humbjet në dispozicion janë të përcaktuara duke krahasuar procedura me shumën e bartur. Këto përfshihen në fitim apo humbje. Kur aktet e rivlerësuar shiten, është politikë e Kompanisë që çdo shumë të transferohet përfshirë edhe rezervat e tjera në lidhje me ato pasuri në mënyrë që të rikthehen fitimet.

Zhvlerësimi njehsohet duke përdorur metodën e bazës lineare për të caktuar koston apo shumën e rivlerësuar, neton e vlerës së mbetur, përgjatë jetës së mbetur të dobishme ose, në rastin e kontratës së qirasë dhe disa impiante dhe pajisje me qira, kushti për qira më të shkurtë vlen si në vijim:

Lloji i pasurisë	Jetëgjatësia e dobishme
Ndërtesat dhe rrjeti i transmetimit	2-50 Vjet
Impiante dhe makineri	7-15 Vjet
Mobilitet, qrendi dhe pajisje	2-16 Vjet

2.9 PASURITË E PAPREKSHME

Pasuritë e paprekshme të Kostt SH.A konsistojnë nga licenca dhe programe (softuerike) me jetëgjatësi të vlefshme të kufizuar. Në njohje fillestare, pasuritë e paprekshme të kërkuara veçmas maten me kosto. Kostoja e një pasurie të kërkuar veçmas përfshin çmimin e saj të blerjes, duke përfshirë këtu edhe detyrimet e importimit dhe taksa të blerjes që nuk rimburohen, pas zbritjes të tregtisë me ulje apo zbritje dhe çdo kosto drejtpërdrejt i atribueshëm të pasurisë të përgatitur për përdorimin e paraparë të tij.

Pas regjistrimit primar, pasuritë e paprekshme barten me kosto më të ulët nga amortizimi i grumbulluar dhe humbja nga dëmtimet. Amortizimi regjistrohet në bazë lineare për jetëgjatësinë e vlefshme të llogaritur. Jetëgjatësia e vlefshme e llogaritur dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të secilës periudhë të raportimit me ndikimin e çfarëdo ndryshimit në vlerësim duke u llogaritur për, në baza të ardhshme. Jetëgjatësia e vlefshme në vijim janë aplikuar:

Lloji i pasurisë

Softueri

Jetëgjatësia e dobishme

5 Vite

Një pasuri e paprekshme çregjistrohet për arsye se është jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi apo asgjësimi i tij. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga mosnjohja e një pasuri jo-materiale njihen në fitim ose humbje kur pasuria çregjistrohet.

2.10 ZHVLERËSIMI I PASURIVE JO-FINANCIARE

Zhvierësimi i pronës, impianteve, pajisjeve dhe mjeteve të paprekshme me jetë të caktuar të përdorimit
Vlera kontabël e këtyre pasurive ndryshon në çdo datë raportimi për shumën e zhvierësimit dhe kur një aset është zhvierësuar, njihet shpenzim përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes në shumën e vlerësuar të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë neto kontabël dhe vlera e tregut minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurisë individuale ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare. Shuma e rikuperueshme përcaktohet për një aset individual, përveç nëse pasuria nuk gjeneron rrjedha monetare të cilat janë kryesisht të pavarura nga ato të pasurive ose grupeve të tjera të pasurive. Në këtë rast, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i takon pasuria.

Vlera në përdorim është vlera e tanishme e vlerësimit të ardhshëm të rrjedhës së parasë të pasurisë/njesisë. Vlerat e tanishme janë të llogaritura duke përdorur normat e zbritjes para tatimit që pasqyrojnë vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të asaj pasurie/njesisë dëmtimet e të cilës janë duke u llogaritur.

Humbjet nga zhvierësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare alokohen së pari kundër emrit të mirë të njësisë dhe më pas pro rata midis aktiveve të tjera të njësisë. Rritjet e mëpasshme në shumën e rikuperueshme të shkaktuara nga ndryshimet në vlerësimet janë kredituar në fitim ose humbje në masën që ata e kthejnë zhvierësimin.

2.11 INVESTIMET NE SHOQERI DHE SIPERMARRJE TE PERBASHKETA

Investimet ne shoqeri dhe sipermarrje te perbashketa llogariten duke përdorur metodën ekuitetit. Vlera kontabël e investimit në shoqeri dhe sipermarrje te perbashketa rritet ose zvogëlohet për të njohur pjesën e Kompanisë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të shoqërisë dhe sipermarrjeve te perbashketa, rregulluar kur është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri me politikat kontabël të Kompanisë.

Fitimet dhe humbjet e përealizuara në transaksionet midis Kompanisë dhe shoqerive dhe sipërmarrjeve të përbashkëta eliminohen në masën e interesit të Kompanisë në ato njësi ekonomike. Kur eliminohen humbjet e përealizuara, pasuria themelore testohet gjithashtu për zhvierësim.

2.12 GRANTE QEVERTARE

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ketë siguri të arsyeshme se Kompania do të përmbushë kushtet që u bashkangjiten atyre granteve dhe se grantet do të merren.

Grantet qeveritare, kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose përndryshe të përvetësojë pasurinë afatgjatë njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar dhe transferohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes mbi një bazë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të pasurisë.

Grantet e tjera qeveritare njihen si të ardhura gjatë periudhave të nevojshme për t'i krahasuar ato me kostot për të cilat synojnë të kompensohen, mbi një bazë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet e ndodhura tashmë ose me qëllim të dhënies së mbështetjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa ndonjë kosto të lidhur në të ardhmen njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

2.13 INVENTARI

Inventari mbahet në pasqyrën e pozicionit financiar në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kosto e inventarit përcaktohet duke përdorur metodën e mesatarës së ponderuar.

Shlyerja është bërë për njësitë e vjetërsuara dhe të dalura nga përdorimi, bazuar në përdorimin e pritshëm të tyre në të ardhmen dhe vlerës neto të realizueshme.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes gjate aktivitetit normal të biznesit pas llogaritjes së të gjitha shpenzimeve të mëtejshme të kompletimit dhe shitjes.

2.14 INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur ai shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korigjuar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme).

Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Pasuritë financiare me kosto të amortizuar.
- Pasuritë financiare me vlera të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL).
- Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).
- Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë aktiv financiar të kategorizuar si FVOCI dhe (FVTPL).
- Klasifikimi përcaktohet nga të dyja:
 - Modeli i biznesit së njësisë ekonomike në menaxhimin e pasurisë financiare.
 - Karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare të cilat njihen në fitim ose humbje janë përfshirë brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare, të cilat paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me kosto të amortizuar atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të përcaktuara si FVTPL):

- ato janë të mbajtura brenda një modeli biznesor, qëllimi i së cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe grumbullimi i flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare prodhojnë flukse të mjeteve monetare, pagesa e kryegjësë dhe interesit, të shumës kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto pasuri maten me kosto të amortizuar përmes metodës efektive të interesit. Zbritja nuk aplikohet atëherë kur efekti i zbritjes është jo material. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera përfshihen tek instrumentet financiare dhe janë klasifikuar si kredi dhe llogari të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2023, pa ndonjë ndryshim në matje.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që janë mbajtur në një model të ndryshëm biznesi përveç "mbajtjes për të mbledhur" ose "mbajtje për të mbledhur dhe shitur", kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga modeli i biznesit të pasurive financiare, për të cilat paratë e kontratës nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesi llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative hyjnë në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilat zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë - me fitimet ose humbjet e njohura në fitim ose humbje. Vlerat e drejta të pasurive financiare në këtë kategori përcaktohen duke iu referuar transaksioneve të tregut aktiv ose duke përdorur një teknikë vlerësimi kur nuk ekziston një treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Llogaritë e Kompanisë përfshinë pasuritë financiare të FVOCI atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, objektivi i të cilit është "mbajtja për të mbledhur" e flukseve monetare shoqëruese dhe shitja e tyre si dhe
- kushtet kontraktuale të këtyre pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit të shumës kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) do riklasifikohet pas mosnjohjes së pasurisë.

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 vënë më tepër në përdorim informacionet e së ardhshmes me qëllim të njohjes së humbjeve të pritura të kreditit - 'modelin e humbjes së pritur të kreditit (HPK)'. Kompania merr në konsideratë një gamë më të gjerë informacionesh, me rastin e vlerësimit së rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritura të kreditit, përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet e tanishme, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që kanë ndikim në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje progresive, dallimi midis tyre bëhet si vijon:

- instrumentet financiare që nuk kanë pësuar përkeqësim të dukshëm të cilësisë së kredisë nisur që nga njohja fillestare, ose ato me rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që cilësinë e kredisë e kanë përkeqësuar dukshëm që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë të së cilave është jo i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' mbulon pasuritë financiare të cilat posedojnë dëshmi objektive të zhvlerësimit të tyre, në datën e raportimit.
- Humbjet e pritshme të kredisë 12-mujore njihen për Fazën 1 ndërsa 'humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës' njihen për Fazën 2 dhe 3. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Kompania vë në përdorim një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, dhe regjistron lejimet për humbjet si jetëgjatësia e humbjeve të pritura të lejimeve për të arkëtueshmet. Këto janë mangësitë e pritura tek flukset e mjeteve monetare kontraktuale, marrë në konsideratë potencialin e mosplotësimit në çdo moment përgjatë ciklit jetësor të instrumentit financiar. Kompania përdor përvojën e saj, treguesit e jashtëm dhe informacionet progresive për llogaritjen e humbjeve të pritura të klejimeve për llogaritë e arkëtueshme duke përdorur matricën e provizionit. Kompania vlerëson zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare të saj në baza kolektive, meqë ato kanë karakteristika të përbashkëta të rrezikut të kredisë, të cilat janë të grupuara në bazën e ditëve të kaluara. Referojuni Shënimit të Rrezikut të Kredisë për një analizë të detajuar të asaj se si aplikohen kërkesat e zhvlerësimit të SNRF 9.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë detyrimet tregtare dhe të pagueshmet të tjera, në datat e raportimit.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, atëherë kur është e zbatueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse detyrimi financiar është paracaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nga Kompania. Më pastaj, detyrimet financiare maten me kosto të amortizuar përmes metodës së interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat e ndërlidhura me interes, dhe, atëherë kur është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti të cilat raportohen në fitim ose humbje përfshihen tek kostot financiare ose tek të ardhurat financiare.

2.15 TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe më pas maten me kosto të amortizuar përmes metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë. Të arkëtueshmet tregtare në përgjithësi kanë afatin e shlyerjes brenda 30 deri 90 ditë.

Për matjen e humbjeve të pritura të kredisë, Kompania ka zbatuar qasjen e thjeshtuar, e cila bën kompensimin e humbjeve të pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së saj. Për të matur humbjet e pritura të kredisë, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të ditëve të vonuara.

Të arkëtueshmet e tjera njihen me kosto të amortizuar duke zbritur çdo kompensim për humbjet e pritura

2.16 PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Vetëm për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë para të gatshme, dhe paratë të mbajtur në një llogari aktuale në ndonjë institucion financiar. Mbitërheqjet bankare janë të paraqitura tek huamarrjet në detyrimet afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.17 KOSTOT E HUAMARRJES

Kostot e huamarrjes kryesisht përbëhen nga interesi për huazimet e Kompanisë. Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një pasurie të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitjeje. Kostot e tjera të huamarrjes janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë kryer dhe raportuar si "kostot e financave".

2.18 TË PAGUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Këto shuma përfaqësojnë detyrimet e papaguara për mallrat dhe shërbimet e ofruara ndaj Kompanisë para fundit të vitit financiar. Për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër, ato maten me kosto të amortizuar dhe nuk zbriten. Shumat janë të pasigurta dhe zakonisht paguhen brenda 30 ditëve që nga njohja e tyre.

2.19 DETYRIMET KONTRAKTUALE

Detyrimet e kontratës përfaqësojnë detyrimin e kompanisë për të transferuar mallra ose shërbime tek një klient dhe njihen atëherë kur një klient paguan konsideratën, ose atëherë kur Kompania bën njohjen e një të arkëtueshme me qëllim që të pasqyrojë të drejtën e pakushtëzuar të saj për shqyrtim (cilado që ndodh më parë) para se Kompania të ketë transferuar mallrat ose shërbimeve ndaj klientit.

2.20 TRANSAKSIONET NË VALUTË TË HUAJA

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare të huaj përkthehen në monedhën funksionale të njësisë ekonomike duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje (përveç kur klasifikohet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse si rrjedhë e parasë nga instrumenti mbrojtës). Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare që janë matur sipas kostos historike në një monedhë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Artikujt jo-monetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj (p.sh. Instrumentet e kapitalit në dispozicion për shitje) përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë përcaktohet.

2.21 PERFITIMET PENSIONALE

Kompania nuk jep asnjë provizion dhe nuk ka asnjë detyrim për pensionet e punonjësve për sa i përket kontributeve të paguara në planin e pensionit të detyrueshëm, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust).

2.22 TATIMI NË FITIM

Tatimi është kalkuluar në pasqyrat financiare në përputhshmëri me ligjin aktual në fuqi të Kosovës mbi tatimet, Ligji nr. 06/L-105 "Tatimi në të Ardhura të Korporatave" në zbatim prej 5 Gusht 2019. Norma e tatimit mbi të ardhurat e tatueshme të korporatave është 10%.

Tatimi aktual llogaritet në bazë të pritshmërisë së fitimit të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi kontabël

Shpenzimi i tatimit për periudhën përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç nëse ajo lind nga transaksione ose ngjarje që janë njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, ose direkt në ekuitet. Në këtë rast, tatimi njihet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse ose direkt, respektivisht në ekuitet. Kur tatimi rrjedh nga kontabilizimi fillestar për një kombinim biznesi, ai është përfshirë në kontabilitet për kombinimin e biznesit. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë njihet në diferencat midis vlerës së bartur të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës tatimore përkatëse të përdorura në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohen duke përdorur metodën e obligimeve të bilancit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe pasuritë tatimore të shtyra njihen në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme.

Vlera kontabël e pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës të pozicionit financiar dhe reduktohen deri në masën që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm do të jetë në dispozicion për të lejuar të gjithë ose një pjesë të pasurisë që të mbulohet.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohen në periudhën kur shlyhet detyrimi ose pasuria e realizuar. Tatimi i shtyrë ngarkohet apo kreditohet në fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me artikuj të ngarkuar ose kredituar direkt në ekuitet, ku tatimi i shtyrë gjithashtu ballafaqohet me ekuitet.

Pasuritë dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen kur ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale kundrejt pasiveve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti organ tatimor dhe kompania ka për qëllim për të zgjidhur pasuritë e saj aktuale tatimore dhe detyrimet në një baza neto.

2.23 TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

Të ardhurat, shpenzimet njihen neto nga shuma e tatimit mbi vlerën e shtuar, përveç kur tatimi mbi vlerën e shtuar nga blerja e pasurive ose shërbimeve nuk është e rimbursueshme nga organet tatimore, në të cilin rast vlera e shtuar është e njohur si pjesë e shpenzimeve për blerje ose si pjesë e kostos sipas rastit; dhe

Shuma neto e TVSH e cila është e rikuperueshme, ose që duhet paguar te autoritetet tatimore është përfshirë si pjesë e arkëtueshme ose detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.24 PROVIZIONET

Një provizion njihet kur Kompania ka një obligim aktual si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, dhe është e mundur se një rrjedhje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer obligimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimeve. Provizionet rishikohen për secilën pasqyrë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe rregullohen për të paraqitur parashikimin më të mirë. Kur efekti kohor i vlerës së parave është material, shuma e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer obligimin.

2.25 EKUITETI

Instrumentet e ekuitetit janë kontratat që i japin një interes të mbetur në pasuritë neto të Kompanisë. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Instrumentet e ekuitetit njihen në shumën e të ardhurave neto të marra të kostove drejtpërdrejt të atribueshme për transaksion. Për aq kohë sa këto të ardhura tejkalojnë vlerën nominale të aksioneve të emetuara ato kreditohen në një llogarinë e premisë së aksioneve.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga vlera e drejtë monetare e kontributeve nga aksionarët.

Fitimet e mbajtura

Fitimet e mbajtura përbehen nga fitimi I pashpërndarë nga periudha aktuale dhe ato të kaluara.

Rivlerësimi I rezervave

Rivlerësimi i rezervave - përfshin fitimet dhe humbjet nga rivlerësimi i pasurive, impianteve dhe pajisjeve.

Shpërndarje dividendë

Dividendët njihen si detyrime, kur ato deklarohen (d.m.th. dividendët janë të autorizuar siç duhet dhe nuk janë më në diskrecionin e njësisë ekonomike). Në mënyrë tipike, dividendët njihen si detyrime në periudhën në të cilën shpërndarja e tyre është aprovuar në mbledhjen e aksionarëve. Dividendët e ndërmjetëm njihen kur paguhen.

2.24 ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveç nëse një rrjedhje e mundshme e burimeve që materializojnë përfitimet ekonomike është e largët. Pasuritë kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur një rrjedhje e beneficioneve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, detyrimin e pësuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.25 TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Kompanisë, bashkë me njësitë që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë ndikim të rëndësishëm mbi operacionet dhe menaxhimin e kompanisë. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie ndërmjet palëve të lidhura, vëmendja është drejtuar në thelbin e marrëveshjes dhe jo thjesht formës ligjore.

2.26 NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Ngjarjet mëpasshme që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Kompanisë, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas periudhës raportuese që nuk janë ngjarje rregulluese shpalosen në shënime nëse janë materiale.

3 GJYKIME TË RËNDËSISHME DHE BURIME KYQE TË VLERËSIMIT TË PASIGURISË

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare, nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime mbi vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshme nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë bazuar në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që janë konsideruar të jenë relevantë. Rezultatet e tanishme mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ai ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon periudhat aktuale dhe të ardhshme.

Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Vlerësimi i vlerës së drejtë të pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në Shënimin 2.8 më lart, Kompania rishikon jetën e dobishme të vlerësuar të pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose ndonjë faktor tjetër mund të ndikojë në jetën e dobishme të pasurive dhe si rrjedhojë mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të këtyre pasurive.

Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në shumën për të cilën vlera bartëse e pasurisë ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Gjatë përcaktimit të shumës së rikuperueshme, Menaxhmenti vlerëson çmimet e pritshme dhe rrjedhën e parasë nga secila njësi gjeneruese të parasë dhe përcakton një normë të interesit të përshtatshme gjatë llogaritjes së vlerës aktuale të rrjedhës së parasë.

Inventari

Inventari vlerësohet me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e stoqeve njehësohet ndaj vlerës së llogaritur të realizueshme kur kostoja e saj nuk është më e rikuperueshme, si në rastet kur stoqet janë të dëmtuar apo vjetërsohet pjesërisht apo plotësisht ose çmimet e tyre të shitjes kanë rënë. Në çdo rast, vlera e realizueshme paraqet vlerësimin më të mirë të shumës së rikuperueshme, e cila bazohet në dëshminë më të besueshme të disponueshme në datën e raportimit, dhe në thelb përfshin vlerësime në lidhje me vlerën e pritshme të realizueshme në të ardhmen. Standardet për përcaktimin e shumës të njehësuar për vlerën e realizueshme neto përfshin analizën e maturimit, vlerësimin teknik, dhe ngjarjet pasuese. Në përgjithësi, një proces i tillë i vlerësimit kërkon gjykim të rëndësishëm dhe mund të ndikojë materialisht në vlerën e bartur të inventarit në datën e raportimit.

Lejimi për humbjet e pritshme kreditore

Lejimi për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Ai bazohet në humbjen e pritur kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë së kreditit, grupuar në bazë të ditëve të vonuara dhe bën supozime për të alokuar një normë të përgjithshme të pritur të humbjes së kredisë për secilin grup. Këto supozime përfshijnë përvojën e fundit të shitjeve dhe normat historike të grumbullimit.

4 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka	Ndërtesat dhe rrjeti i transmisio nit	Impiantet dhe makineria	Automjete , mobilje dhe pajisje të tjera	Puna në Progres	Gjithsej
Kosto/ Kostot e konsideruara						
Me 01 JANAR 2022	5,062	116,379	154,521	8,648	1,102	285,712
Shtesat për vitin	47	117	68	76	2,761	3,069
Transferet nga Puna në progres		196	139	98	(444)	(11)
Teprica	-	-	10	-	-	10
Heqjet nga përdorimi		-	(22)	-	-	(22)
Transferimet në inventar	-	-	-	-	(14)	(14)
Me 31 DHJETOR 2022	5,109	116,692	154,716	8,822	3,405	288,744
Me 01 JANAR 2023	5,109	116,692	154,716	8,822	3,405	288,744
Shtesat për vitin	123	71	52	146	3,766	4,158
Transferet nga Puna në progres		14	-	44	(58)	-
Heqjet nga përdorimi	-	-	(26)	-	-	(26)
Me 31 DHJETOR 2023	5,232	116,777	154,742	9,012	7,113	292,876
ZHVLERËSIMI I AKUMULUAR						
Me 01 JANAR 2022	-	(43,749)	(88,809)	(7,960)	-	(140,518)
Zhvlerësimi për vitin	-	(5,009)	(10,011)	(306)		(15,326)
Me 31 DHJETOR 2022	-	(48,758)	(98,820)	(8,266)		(155,844)
Me 01 JANAR 2023	-	(48,758)	(98,820)	(8,266)		(155,844)
Zhvlerësimi për vitin	-	(4,860)	(9,577)	(211)		(14,648)
Me 31 DHJETOR 2023	-	(53,618)	(108,397)	(8,477)	-	(170,492)
VLERA NETO						
KONTABËL						
Më 31 DHJETOR 2022	5,109	67,934	55,896	556	3,405	132,900
Më 31 DHJETOR 2023	5,232	63,159	46,345	535	7,113	122,384

Shtesat dhe grantet në lidhje me asetet

Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2023 nuk kishte asnjë shtesë në lidhje me zërat e impianteve dhe pajisjeve të marra përmes Grantit.

Shpenzimet e zhvlerësimit që i referohet këtyre pasurive në vlerë prej 6,291 mijë euro (2022: 6,507 mijë euro) lirohet nga të ardhurat e shtyra dhe njihet si e ardhur nga granti në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih shënimin 14).

Shlyerjet

Që nga 31 Dhjetor 2023, bazuar në numërimin fizik vjetor të kryer në pronat, objektet dhe pajisjet, Kompania ka fshirë nga përdorimi pasuritë me vlerën kontabël bruto prej 26 mijë euro (2022: 22 mijë euro, kundrejt fitimit dhe humbjes aktuale, kostoja e së cilës arrin në 26 mijë euro (2022: 22 mijë euro).

Prona, impiantet dhe pajisjet e lëna pengë

Me 31 Dhjetor 2023 dhe 2022, nuk ka asnjë pronë, impiant dhe pajisje të lëna pengë. Të gjitha pasuritë përdoren për aktivitetet operative të Kompanisë.

5 PASURITË E PAPERKSHME

	Software EUR'000
Kosto	
MË 01 JANAR 2022	4,507
Shtesat për vitin	12
MË 31 DHJETOR 2022	4,519
MË 01 JANAR 2023	4,519
Shtesat për vitin	37
MË 31 DHJETOR 2023	4,556
AMORTIZIMI I AKUMULUAR	
MË 01 JANAR 2022	(3,900)
Shpenzimet e amortizimit për vitin	(212)
MË 31 DHJETOR 2022	(4,112)
MË 01 JANAR 2023	(4,112)
Shpenzimet e amortizimit për vitin	(169)
MË 31 DHJETOR 2023	(4,281)
VLERA NETO KONTABËL	
MË 31 DHJETOR 2022	407
MË 31 DHJETOR 2023	275

6 INVESTIMET NË SHOQËRI

Më 5 tetor 2020, Kompania dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë - ALPEX. Procesi i krijimit të ALPEX filloi në Mars 2020 kur qeveria shqiptare nisi një tender për kompanitë e interesuara për t'u bërë aksionerë. Ajo u pezullua për shkak të pandemisë COVID-19 në Prill, dhe në fund të Qershorit u përzgjedhën aksionarët. Kompania zotëron 42,75% ndërsa administratori i OST Shqipëri zotëron 57,25%. Investimi në ALPEX llogaritet duke përdorur metodën e ekuitetit. Më 31 dhjetor 2023, investimi në shoqëri arriti në 362 mijë euro (2022: 617 mijë euro).

Llogaritja e vlerës kontabël të investimit dhe ndryshimet gjatë vitit

	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Pasuritë afatgjata	112	123
Pasuritë afatshkurtër	7,414	1,349
	7,526	1,472
Detyrimet afatgjata	-	-
Detyrimet afatshkurtër	6,678	38
	6,678	38
Neto asetet	847	1,434
	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Te ardhurat	448	-
Shpenzimet	(1,181)	(452)
Humbja neto për vitin	(734)	(452)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-
Humbja neto dhe të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin	(734)	(452)
	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Pasuritë neto të shoqërisë	847	1,434
Proporcioni i interesit të pronësisë së Kompanisë në ALPEX	42.75%	42.75%
Vlera Kontabel e investimeve në shoqëri	362	617
Mínus: Konsiderata e transferuar	(617)	(868)
Pjesa e akumuluar në fitim dhe humbje në shoqëri	(255)	(251)
Pjesa në fitim dhe humbje në shoqëri për vitin	(255)	(251)

Për fundin e vitit 2023 Kompania ka njohur pjesën e humbjes në shoqëri në vlerë prej 255 mijë euro dhe kjo shumë ka ulur vlerën kontabël të investimit në shoqëri.

	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Më 1 Janar	617	868
Konsideratat e dhëna	-	-
Dividentet e pranuar	-	-
Pjesa e fitimit dhe humbjes në shoqëri	(255)	(251)
Më 31 Dhjetor	362	617

7 INVESTIMET FINANCIARE

Më 4 korrik 2012 një kompani u themelua dhe u regjistrua si Kompania Projektuese Ekipore me Përgjegjësi të Kufizuar me përgjegjësi për krijimin e një Zyre të Koordinuar të Ankandit në Evropën Juglindore d.o.o, me vendndodhje në Podgorica (CAO SEE). Është themeluar nga TEL (Rumania), Eles (Slloveni), HEP OST (Kroaci), BIH ISO (Bosnjë dhe Hercegovinë), MEPSO (Maqedoni), OST (Shqipëri), HTSO (Greqi), TEIAS (Turqi) dhe KOSTT (Kosovë). Këto kompani kanë kontribuar me 30% në kapitalin aksionar të këtij entiteti, ndërsa 70% në kapitalin aksionar kanë kontribuar institucionet ndërkombëtare të financimit (BERZH, KfW dhe USAID)

Kompania ka investuar një shumë prej 28 mijë EUR në kapitalin aksionar të CAO SEE me 4 korrik 2012 që përfaqëson 1% të aksioneve. Gjatë vitit 2014 kapitali aksioner i CAO SEE është dyfishuar dhe kështu ka kontribuar në rritjen e kapitalit në vlerë prej 40 mijë EUR. Përqindja e zotërimit të KOSTT në 31 dhjetor 2023 ishte 1% (31 dhjetor 2022: 1%).

8 STOQET

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Pjese rezervë	3,825	3,623
Materialet dhe të shpenzueshmët	936	954
Të tjera	129	118
Karburant dhe lubrifikantë	21	29
	4,910	4,723
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(316)	(316)
	4,595	4,407

Më 31 Dhjetor 2023 janë pranuar përmes granteve stoqe në vlerë prej 129 mijë euro.

9 TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Të arkëtueshmet tregtare		
Debitorët tregtarë	35,559	40,156
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(736)	(1,331)
	34,823	38,825
Huadhëniet dhe parapagimet		
Parapagimet ndaj furnitorëve	545	1,185
	545	1,185
	35,369	40,011
Të arkëtueshmet e tjera		
Të arkëtueshmet për jobalancat	22,995	43,625
Minus: Provizioni për zhvlerësim për jobalancat	-	(1,681)
TVSH e arkëtueshme	-	-
Avanset për punëtorët	148	211
Të arkëtueshme tjera	2,784	1,935
	25,927	44,090
GJITHSEJ TË ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA	61,296	84,101

Pas datës raportuese kemi pranuar pagesa nga klient në vlerë 561 mijë euro, të cilet kanë qenë në vonesë për pagesa, dhe ne kete menyre eshte zvogëluar vlera e provizioneve për llogari të arkëtueshme nga jobalanca.

Lëvizja në provizionimin e llogarive të arkëtueshme është si më poshtë:

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Gjendja fillestare me 1 Janar	3,012	-
Shpenzimi për vitin	-	3,012
Lirimi i provizionimit	(2,276)	-
Gjendja përfundimtare më 31 dhjetor	736	3,012

Të arkëtueshmet për jobalancat

* Bazuar në Ligjin për energji elektrike, duke filluar nga viti 2017, Kompania hyri dhe u bë përgjegjëse për balancimin e sistemit të sapo strukturuar të energjisë elektrike të Kosovës në përputhje me Kodin e rregullor të transmisionit dhe rregullatorit të tregut. Si rezultat i kësaj, të arkëtueshmet dhe detyrimet përkatëse për zhbalancim njihen në regjistrat kontabël në pasqyrat financiare të Kompanisë (shih gjithashtu Shënimin 16).

10 DEPOZITAT ME AFAT

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Depozitat me afat në bankat lokale	-	-
Depozita në para në bankat ndërkombëtare	4,800	4,800
Interesi i përlogaritur	-	-
GJITHSEJ DEPOZITAT ME AFAT	4,800	4,800

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 depozitat në shumën prej 4,800 mijë Euro janë lënë peng si kolateral për huazimet ndaj KFW (Shënimi 15).

11 PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Paraja në bankë	26,747	67,273
TOTALI I PARASË DHE EKVIVALENTËVE TË PARASË	26,747	67,273

12 KAPITALI AKSIONAR

	2023	2022
	Shuma në EUR'000	Shuma në EUR'000
	% e interest të ekuitetit	% e interest të ekuitetit
Kuvendi i Kosovës	25	25
	25	25
	100%	100%

Kapitali aksionar përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1 EUR secili. Pronar i KOSTT Sh.A është Kuvendi i Republikës së Kosovës, që zotëron 100% të kapitalit të zakonshëm të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2023 (31 Dhjetor 2022: 100%)

13 REZERVA E TRANSFERIT

Rezervat e transferit, konsiston në rritjen e kapitalit aksionar në vlerë prej 53,377 mijë EUR që ishte një kontribut jo-monetar përmes transferimit të aseteve nga KEK SH.A. tek Kompania në datën e

balancimit të saj sipas marrëveshjes ndërmjet Kompanisë dhe KEK SH.A.

14 GRANTET E SHTYERA

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Granti në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet	34,816	41,107
Grant lidhur me shpenzimet e humbjeve të energjisë	-	-
Granti në lidhje me inventarin	2,034	1,927
	36,850	43,034

Grantet lidhen me fondet ose pasuritë e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të siguruar mbështetje financiare për aktivitetet operative dhe projektet kapitale të Kompanisë, të cilat janë në zhvillim e sipër, projektet e ardhshme kapitale dhe për mbulimin e humbjeve të energjisë në zonën Veriore të Republikës së Kosovës.

Lëvizjet gjatë vitit

Tabela vijuese përmbledh lëvizjet në grantin e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor:

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Më 1 Janar	43,034	49,583
Grantet e pranuar	12,009	57,500
Minus:		
Të ardhurat e shtyra në P&L (shih tabelën më poshtë)	(18,193)	(64,049)
Më 31 Dhjetor	36,850	43,034

Më poshtë është analiza e grantit të lëshuar për P&L dhe llogaritet si e ardhur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Zhvlerësimi i pajisjeve (Shënimi 4)	6,291	6,507
Shpenzimet në lidhje me humbjet e energjisë në veri (21)	11,880	57,500
Inventari (Shënimi 8)	22	42
	18,193	64,049

15 HUATË

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Huatë KfW (shuma 17,000 mijë EUR maturimi 2024)	1,000	3,000
Huatë KfW (shuma 23,500 mijë EUR maturimi 2047)	11,115	12,878
Huatë EBRD (shuma 30,000 mijë EUR maturimi 2029)	14,339	16,721
Hua Qeveria e Kosovës (shuma 26,440 mijë EUR maturimi 2023)	-	26,441
	26,454	59,040
Pjesa qarkulluese	5,145	32,457
Pjesa jo-qarkulluese	21,309	26,583
GJITHSEJ HUATË	26,454	59,040
RAKORDIMI I BORXHIT NETO	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	31,547	72,073
Huamarrjet e pagueshme brenda një viti	(5,145)	(32,457)
Huamarrjet e pagueshme pas një viti	(21,309)	(26,583)
BORXHI NETO	5,093	13,033

Një marrëveshje kredie dhe financimi e datës 26 Shkurt 2022 midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Kompania e ka marrë këtë hua për qëllime ekskluzive për mbulimin e detyrimeve financiare në lidhje me devijimet e shkaktuara në sistemin e interkonjeksionit të Evropës ENTSO-E. Pagesa e kredisë është realizuar gjatë vitit 2023.

Një marrëveshje kredie dhe financimi e datës 28 dhjetor 2009 midis KfW dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Projekti parashikon ndërtimin e Linjës së Transmisionit 400kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë). Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit është 33 500 mijë EUR e përbërë nga 16 500 mijë EUR kontribut financiar dhe kredi deri në 17 000 mijë EUR. Kontributi financiar nuk është i pagueshëm. Kredia filloi të tërhiqej në 2015.

Një marrëveshje kredie dhe financimi e datës 23 shtator 2013 midis KfW dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit të transmetimit - Faza IV dhe V. Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit është 30 850 mijë EUR që përbëhet nga 3,000 mijë EUR kontribut financiar i KfW për Qeverinë e Republikës së Kosovës të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës e ka transferuar të KOSTT në formë kredie, kredi deri në 20 500 mijë EUR dhe 7 350 mijë EUR të financuara nga Bashkimi Evropian. Kontributi financiar nuk është i pagueshëm. Kredia filloi të tërhiqej në 2015.

Një marrëveshje kredie e datës 15 tetor 2014 u nënshkrua midis Kompanisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky projekt do të implementohet brenda 4 viteve nga data e kontratës. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit ekzistues të transmetimit të energjisë së Kompanisë. Projekti është pjesë e planit katër vjeçar të investimeve kapitale të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRE) dhe do të përfshijë ndërtimin, rehabilitimin dhe vënien në punë të nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të transmetimit të energjisë elektrike të zgjedhura. Kostoja totale e

janë si më poshtë: 4,500 mijë nga fondet e Kompanisë, 2,000 mijë EUR nga fondet e Donatorëve, Borxhi i Vjeter (BERZH) 30,000 mijë EUR.

Një marrëveshje kredie është nënshkruar me datën 29 Dhjetor 2022 midis KfW , Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës dhe Kompanisë KOSTT. Kredia është nën-huazim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Sipas legjislacionit të borxhit publik vetëm Qeveria e Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave mund të marrë kredi ndërkombëtare. Kryegjeja e kredisë është me KfW. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit të transmetimit – Faza VII . Shuma totale e kredisë është 25,500 mijë EUR. Kredia fillon të tërhiqet në vitin 2024.

16 DETYRIMET TREGTARE DHE TË TJERA

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Të pagueshmet tregtare:		
Kreditorët/ furnitorët e jashtëm	1,694	2,237
Kreditorët/ furnitorët vendor	35,568	34,449
	37,262	36,686
Të pagueshmet tjera afatshkurtë		
Detyrimet për jobalancat	23,470	41,426
Provizionet për detyrimet	5,728	5,531
Tatimi mbi vlerën e shtuar	115	868
Pagat neto të pagueshme	338	324
Tatimi në paga dhe kontributet pensionale	75	107
Llogari të pagueshme tjera	330	414
	30,056	48,670
GJITHSEJ DETYRIME TREGTARE DHE TË TJERA	67,318	85,356

*Sipas Ligjit për energji elektrike dhe licencave, Kostt SH.A përveç tjerash është përgjegjëse edhe për balancimin e sistemit të energjisë elektrike. Në nenin 16 të Ligjit për energji elektrike në paragrafin 1.19 të këtij neni Operatori i Sistemit është përgjegjës për " balancimin e sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit dhe Rregullat e tregut". Meqenëse energjia elektrike si produkt i cili liferohet në kohe reale çdo here lajmërohet diference në mes sasisë së kontraktuar dhe sasisë së prodhuar gjegjësisht të konsumuar. Diferenca në mes energjisë së kontraktuar për liferim dhe energjisë së liferuar të matur e një nga një pale tregtare quhet jo balancë e palës dhe pala tregtare është përgjegjëse për koston që ka shkaktuar.

Lëvizjet në detyrimet e provizioneve janë si më poshtë ;

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Shuma e mbartur në fillim të vitit	5,531	5,280
Provizionet shtesë të njohura për Pretendimet Ligjore	197	251
Shuma e mbartur në fund të vitit	5,728	5,531

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023 Kompania ka njohur provizione në vlerë prej 5,728 mijë, nga të cilat 1,513 mijë EUR kanë të bëjnë me procedurat ligjore të filluara kundër kompanisë (Shënimi 30 Zotimet dhe kontigjencat) dhe 4,215 mijë EUR kanë të bëjnë me provizionet për detyrimet tregtare që

17 TË ARDHURAT

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Të ardhurat nga transmisioni i energjisë	13,431	12,448
Të ardhurat nga operatori i sistemit	23,082	21,978
Të ardhurat nga operatori i tregut	287	294
GJITHSEJ TË ARDHURAT	36,800	34,720

18 TË ARDHURAT TJERA OPERATIVE

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve	8,161	9,231
Të ardhurat nga mbulimi i humbjeve(vendimi ZRrE)	-	6,057
Të ardhurat e tjera	203	365
Të ardhurat nga energjia tranzit	777	501
Të ardhurat nga jobalacat e brendëshme	(0)	35
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA	9,141	16,189

19 TË ARDHURAT/SHPENZIMET NGA BURIMET E RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË

	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Të ardhurat		
Të ardhurat nga burimet e energjisë së ripërtëtitshme	46,794	43,439
Shpenzimet		
Shpenzimet nga burimet e energjisë së ripërtëtitshme	(51,925)	(42,203)
Gjithsej shpenzimet/të ardhurat, neto	(5,131)	1,236

Të ardhurat nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë janë realizuar bazuar në rregullën nr. 10/2017 nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës ('ZRRE)

20 TË ARDHURAT TJERA NGA GRANTET

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
Amortizimi i granteve të shtyra të lidhura me PIP dhe stok	6,313	6,549
Amortizimi i granteve të shtyra në lidhje me paratë e paguara	11,880	57,500
GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA NGA GRANTET	18,193	64,049

21 HUMBJA E ENERGJISË

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Humbja në transmetimin e energjisë	8,942	14,889
Humbja e energjisë në komunitat e veriut	26,789	63,177
GJITHSEJ HUMBJA E ENERGJISË	35,731	78,067

Gjatë vitit 2023, Kompania njohu humbje në transmetimin e energjisë në shumën prej 8,942 mijë EUR (2022: 14,889 mijë EUR). Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit paraqiten si një ndryshim midis energjisë elektrike të matur në hyrjen e rrjetit të transmisionit dhe energjisë së matur në daljen e rrjetit të transmisionit.

Po ashtu, gjatë vitit 2023 kompania ka njohur shpenzime të humbjeve të energjisë për komunitat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviçit dhe Zubimopotok në vlerë prej 26,789 mijë euro (2022: EUR 63,177 mijë euro).

22 SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Kostot e shërbimeve ndihmëse	17,777	9,887
Shpenzimet për tranzitin e energjisë	1,971	181
Shpenzimet e energjisë dhe karburantit	386	305
Shpenzimet e tjera	353	416
Shpenzimet e provizionuara ligjore	197	251
Shpenzimet e rojeve të sigurisë	169	162
Shpenzimet e zyrës dhe inventarit të imët	88	57
Pagesa e gjobës dhe interesit	86	483
Shpenzimet e marketingut dhe përfaqësimit	58	27
Tatimi në prona dhe tatimet tjera	44	34
Shpenzimet e shërbimeve komunale	38	40
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	28	35
Këshillim dhe shërbime të tjera	21	15
Shpenzimet mjekësore	19	20
Shpenzimet e sigurimit të automjeteve	19	15
Shpenzimet për jobalancat	-	571
GJITHSEJ SHPENZIMET TJERA OPERATIVE	21,253	12,499

23 SHPENZIMET E PERSONELIT

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Pagat e personelit	4,651	4,737
Kontributet pensionale	490	500
Pagat për Bordin e Drejtorëve	106	104
Pagat për punëtorët e kontraktuar	12	4
GJITHSEJ SHPENZIMET E PERSONELIT	5,258	5,345

24 RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJET

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve	506	606
GJITHSEJ RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJET	506	606

25 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Të hyrat		
Të hyrat nga interesi	889	1,845
	889	1,845
Shpenzimet		
Shpenzimet e interesit	(1,612)	(1,456)
TË HYRAT FINANCIARE /(SHPENZIMET), NETO	(723)	389

26 SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM

Sipas Ligjit mbi tatimin ne te ardhurat e Korporatave No 06/L -105 që është efektiv nga 5 Gusht 2019, Kompania është e detyruar që të paguaj tatimin mbi të ardhurat në një normë prej 10% mbi fitimin e tatueshëm, e llogaritur në Deklaratën vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat. Ngarkesa e vitit mund të harmonizohet më fitim në pasqyren e të ardhurave gjithëpërfshirëse si në vijim:

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Fitimi para tatimit	(17,264)	1,265
Te ardhurat nga dividenda		
Të ardhurat (jo)të zbritshme	2,276	-
	2,276	-
Rregullimi i zhvlerësimit	1,589	(4,711)
Humbjet e bartura tatimore	(10,421)	(11,008)
Shpenzimet jo të zbritshme	609	4,033
	(8,223)	(11,686)
Diferenca ndërmjet tatimit dhe vlerës kontabël të Pronës, impiantit dhe pajisjeve		
Fitimi/humbja para tatimit	(23,211)	(10,421)
SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM		-

26 SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM

Sipas Ligjit mbi tatimin ne te ardhurat e Korporatave No 06/L -105 që është efektiv nga 5 Gusht 2019, Kompania është e detyruar që të paguaj tatimin mbi të ardhurat në një normë prej 10% mbi fitimin e tatueshëm, e llogaritur në Deklaratën vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat. Ngarkesa e vitit mund të harmonizohet më fitim në pasqyren e të ardhurave gjithëpërfshirëse si në vijim:

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Fitimi para tatimit	(17,264)	1,265
Te ardhurat nga dividenta	2,276	-
Të ardhurat (jo)të zbrtishme	<u>2,276</u>	<u>-</u>
Rregullimi i zhvlerësimit	1,589	(4,711)
Humbjet e bartura tatimore	(10,421)	(11,008)
Shpenzimet jo të zbritshme	<u>613</u>	<u>4,033</u>
	(8,219)	(11,686)
Diferenca ndërmjet tatimit dhe vlerës kontabël të Pronës, impiantit dhe pajisjeve		
Fitimi/humbja para tatimit	<u>(23,208)</u>	<u>(10,421)</u>
SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM		-

Tatimet e shtyra që rrjedhin nga dallimet e përkohshme janë të përmbledhura si në vijim:

	Shuma bartese	Baza për tatim	Diferenca e përkohshme	Norma e tatimit	Detyrimi tatimor i shtyrë
Pasuritë Neto më 31 Dhjetor 2022	124,783	59,387	65,396	10%	6,540
Pasuritë Neto më 31 Dhjetor 2023	110,279	46,475	63,804	10%	6,380
Lëvizja e diferencave të përkohshme gjatë vitit 2023 dhe 2022:					159
				Detyrimi tatimor i shtyrë	
Më 31 Dhjetor 2022				<u>6,539</u>	
Përfitimi nga tatimi mbi fitim i shtyrë i njohur gjatë vitit 2023				<u>(159)</u>	
Më 31 Dhjetor 2023				<u>6,380</u>	
				2023 EUR'000	2022 EUR'000
Shpenzimi aktual i tatimit në fitim				-	-
Te hyrat/(Shpenzimi) i tatimit të shtyrë				159	(471)
				<u>159</u>	<u>(471)</u>

28 MATJA E VLERËS SË DREJTË

Instrumentet financiare të njohura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila i grupon pasuritë dhe detyrimet në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si në vijim:

- Niveli 1: Çmimet e kuotuarra (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuri dhe detyrime identike që njësia ekonomike mund të përdorë në datën e matjes;
- Niveli 2: Të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuarra, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte dhe
- Niveli 3: Të dhënat për pasuri ose detyrime që nuk janë të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme tregu (të dhëna të pavëzhgueshme).

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, Kompania nuk ka pasuri financiare të matura me vlerë të drejtë.

Instrumentet financiare që nuk janë paraqitur me vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmbledh shumat bartëse dhe vlerat e drejta për ato pasuri dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera e bartur		Vlera e drejtë	
	2023	2022	2023	2022
	EUR	EUR	EUR '000	EUR '000
	'000	'000		
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	26,747	67,273	26,747	67,273
Depozitat me afat	4,800	4,800	4,800	4,800
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	60,751	82,916	60,751	82,916
GJITHSEJ PASURI FINANCIARE	92,298	154,989	92,298	154,989
Detyrimet				
Detyrimet tregtare dhe të tjera	60,733	78,112	60,733	78,112
Huatë që bartin interes	26,454	59,040	26,454	59,040
GJITHSEJ DETYRIME FINANCIARE	87,187	137,152	87,187	137,152

Depozitat me afat dhe të arkëtueshmet

Depozitat me afat dhe të arkëtueshmet mbahen me kosto të amortizimit, minus provizionet për zhvlerësim. Për shkak të maturitetit të shkurtë, vlera e tyre e drejtë i përgjigjet vlerës së tyre bartëse.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Vlera e drejtë e pasurive monetare që përfshin paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat e tyre bartëse sipas definicionit dhe për shkak të maturitetit të shkurtë prej më pas se 3 muaj.

Të pagueshmet tregtare dhe huatë

Vlera bartëse e të pagueshmëve tregtare dhe të tjera i afrohet vlerës së tyre të drejtë për shkak të maturitetit të tyre afat shkurtër.

29 INFORMACIONE MBI RREZIQET FINANCIARE

Kompania i ekspozohet risqeve të ndryshme financiare në lidhje me instrumentet financiare. Pasuritë dhe detyrimet financiare të Kompanisë sipas kategorisë janë të përmbledhura në Shënimin 26. Llojet kryesore të risqeve janë risku i tregut, risku kreditor dhe risku i likuiditetit.

Menaxhimi i riskut të Kompanisë është i koordinuar nga menaxhmenti, në bashkëpunim të ngushtë me bordin e drejtorëve, dhe fokusohet që në mënyrë aktive të siguroj rrjedhat e parasë afatshkurtra dhe afatmesme të Kompanisë duke minimizuar ekspozimin e tyre ndaj tregjeve financiare të paqëndrueshme. Investimet financiare afatgjata janë të menaxhuara për të gjeneruar kthime të qëndrueshme. Investimet afatgjata financiare menaxhohen për të gjeneruar kthime të qëndrueshme. Kompania nuk angazhohet në tregtimin e pasurive financiare për qëllime spekulative dhe as nuk shkruan opsione. Risqet më të rëndësishme financiare nga të cilat Kompania është e ekspozuar janë përshkruar më poshtë.

a) Risku kreditor

Risku i kredisë menaxhohet në baza grupore. Nëse klientët me shumicë vlerësohen në mënyrë të pavarur, këto vlerësime përdoren. Përndryshe, nëse nuk ka vlerësim të pavarur, kontrolli i riskut vlerëson cilësinë e kredisë së klientit, duke marrë parasysh pozicionin e tij financiar, përvojën e kaluar dhe faktorët e tjerë. Kufijtë individual të riskut përcaktohen bazuar në vlerësimet e brendshme ose të jashtme, në përputhje me kufijtë e vendosur nga bordi. Pajtueshmëria me kufijtë e kredisë nga klientët me shumicë monitorohet rregullisht nga menaxhimi i linjës. Nuk ka garanci ndaj kësaj të arkëtueshme, por menaxhmenti monitoron nga afër gjendjen e të arkëtueshmeve në baza mujore dhe është në kontakt të rregullt me këtë klient për të zbutur rrezikun

Ekspozimi maksimal i Kompanisë ndaj riskut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Klasat e pasurive financiare - shumat bartëse		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	60,751	82,916
Depozitat me afat	4,800	4,800
	26,717	67,273

Kompania nuk mban kolateral për ndonjë të arkëtueshme të saj. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme për të cilat ekziston evidencë objektive e zhvlerësimit janë zhvlerësuar në mënyrë të duhur.

Të arkëtueshmet tregtare

Kompania ka krijuar politika për të siguruar që shitjet e shërbimeve u bëhen klientëve me një histori krediti të përshtatshme. Kompania ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë ndaj çdo pale të kundërt.

Menaxhmenti i Kompanisë beson se shumtë e vonuara por jo të zhvlerësuar janë të arkëtueshme, bazuar në sjelljen historike të vjetërsisë së pagesës dhe riskun e kredisë së klientit.

Vjetërsia e të arkëtueshmeve është si më poshtë:

	2023	2022
	EUR'000	EUR'000
0- 30 ditë	22,300	21,077
31-90 ditë	11,312	8,375
Mbi 90 ditë	1,947	10,704
	35,559	40,156
Minus: Provizonet për zhvlerësim	(736)	(1,331)
	34,823	38,825

Llogaritë e Arkëtueshme nga jo-balancat

Sipas Ligjit për energjinë elektrike dhe licencat, KOSST sh.a përveç të gjithave është përgjegjëse edhe për balancimin e sistemit të energjisë elektrike. Në nenin 16 të Ligjit për energjinë elektrike në nenin 1.19 të këtij neni, Operatori i Sistemit është përgjegjës për: “balancimin e sistemit të strukturuar të energjisë elektrike në përputhje me Kodin e Rregullatorëve të Rrjetit të Transmetimit dhe Tregut”. Edhe pse energjia elektrike si produkt i cili shpërndahet në kohë reale gjithmonë shpallet dallimi në mes të sasisë së kontraktuar dhe sasisë së prodhuar përkatësisht të konsumuar. Diferenca midis energjisë së kontraktuar për shpërndarje dhe energjisë së matur të dorëzuar të njëres prej palëve tregtare quhet çekuilibër i jobalancimit të palës dhe pala tregtare është përgjegjëse për koston që ka shkaktuar. Kompania ka politika që kufizojnë shumën e ekspozimit të kredisë ndaj çdo pale.

Më 23 mars 2023, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka vendosur në favor të Kompanisë dhe ka këshilluar KEDS sh.a dhe KESCO sh.a që të shlyejnë bilancet e kontestuara të të arkëtueshmeve tregtare nga jobalancat e kontestuara nga KESCO sh. a dhe KEDS sh.a përkatësisht 11,445 mijë euro dhe 3,738 mijë euro.

Gjate vitit 2023 të gjitha këto llogaritë të arkëtueshme nga jo balanca të kontestuara janë arketuar.

b) Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe të letrave me vlerë të tregtueshme, si dhe disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet lehtësive adekuate të kredisë dhe aftësinë për të mbledhur shumtë e duhura nga klientët në kohën e duhur, brenda afateve të përcaktuara. Për shkak të natyrës dinamike të Kompanisë, menaxhmenti synon të mbajë fonde likuide dhe mbajtur linjat e kreditit të zotuar në dispozicion. Tabelat në vijim paraqesin maturitetet e

kontraktuara të mbetura të detyrimeve financiare të Kompanisë. Tabelat janë të përgatitura në baza të rrjedhës së parasë të pa zbritur të detyrimeve financiare.

31 dhjetor 2023	Afatshkurtë		Afatgjatë		Gjithsej
	Brenda 1 viti	1 deri 2 vite	2 deri 5 vite	Mbi 5 vjet	
	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000	
Huatë	5,145	3,334	7,569	10,406	26,454
Llogaritë e pagueshme tregtare	67,318	-	-	-	67,318
	72,463	3,334	7,569	10,406	93,772

31 dhjetor 2022	Afatshkurtë		Afatgjatë		Gjithsej
	Brenda 1 viti	1 deri 2 vite	2 deri 5 vite	Mbi 5 vjet	
	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000	
Huatë	32,587	5,278	9,160	12,015	59,040
Llogaritë e pagueshme tregtare	78,112	-	-	-	78,112
	110,699	5,278	9,160	12,015	137,152

c) Risku i tregut

Risku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si kurset e këmbimit të huaj dhe normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Kompanisë ose vlerën e zotërimeve të saj të instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, përderisa optimizon kthimin.

d) Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe risku që maturitetet e pasurive që bartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që bartin interes të përdorura për të financuar ato pasuri (risku i rëçimit). Kohëzgjatja e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar në këtë mënyrë tregon se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, Kompania nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të normës së interesit.

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Pasuritë financiare		
<i>Që nuk bartin interes</i>		
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	60,751	82,916
Paraja ne arkë	1	0
<i>Me normë të interesit të përcaktuar</i>		
Balancat bankare	26,747	67,273
Depozitat me afat	4,800	4,800

d) Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe risku që maturitetet e pasurive që bartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që bartin interes të përdorura për të financuar ato pasuri (risku i rëçimit). Kohëzgjatja e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar në këtë mënyrë tregon se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, Kompania nuk është e ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të normës së interesit.

	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Pasuritë financiare		
<i>Që nuk bartin interes</i>		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	60,751	82,916
Paraja ne arkë	1	0
<i>Me normë të interesit të përcaktuar</i>		
Balancat bankare	26,747	67,273
Depozitat me afat	4,800	4,800
	92,299	152,842
Detyrimet financiare		
<i>Që nuk bartin interes</i>		
Detyrimet e tregtueshme dhe të tjera	67,318	85,356
<i>Me normë fikse interesi</i>		
Huatë që bartin interes	26,454	59,040
	93,772	144,396

e) Risku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit pasi që Kompania nuk ka transaksione në valutë të huaj.

30 MENAXHIMI I RISKUT KAPITAL

Objektivat e Kompanisë në menaxhimin e kapitalit janë që të mbrojnë aftësinë për të vazhduar me vijimësinë në mënyrë që të ofrojnë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera të interesit dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit.

Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij auditimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe riskun e lidhur me secilën klasë të kapitalit. Raporti i borxhit.

Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me secilën klasë të kapitalit.

The gearing ratio at year end is as follows:

	2023 EUR'000	2022 EUR'000
Huatë	26,454	59,040

31 PALËT E LIDHURA

Një palë është e lidhur me një entitet nëse, drejtpërdrejt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, pala ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj një ndikim të rëndësishëm mbi njësinë ekonomike, pala ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike, pala është një bashkëpunëtorë ose partia është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike ose shoqërisë mëmë të saj.

Kompania ka transaksione të palëve të lidhura gjatë rrjedhës normale të aktiviteteve të biznesit. Tabela më poshtë paraqet vëllimin dhe bilancet nga transaksionet e palëve të lidhura që prej dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2023 dhe 2022.

	Grantet e shtyra EUR '000	Të ardhurat nga njohja e granteve EUR '000	Shpenzimet EUR '000
31 Dhjetor 2023			
Qeveria e Kosovës dhe KfW	36,850	18,193	
Kompensimi i menaxhmentit kyç			144
Anëtarët e Bordit			106
	36,850	18,193	250

	Grantet e shtyra EUR '000	Të ardhurat nga njohja e granteve EUR '000	Shpenzimet EUR '000
31 Dhjetor 2022			
Qeveria e Kosovës	43,034	64,049	
Kompensimi i menaxhmentit kyç			148
Anëtarët e Bordit			104
	43,034	64,049	252

32 ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT*Çështjet ligjore*

Kohë pas kohe dhe në rrjedhën normale të biznesit, pretendime kundër Kompanisë mund të pranohen. Mbi bazën e vlerësimeve të veta dhe të këshillave të brendshme dhe të jashtme profesionale, menaxhmenti është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet që tejkalojnë provizionet që janë bërë në këto pasqyra financiare.

Më 31 dhjetor 2023 Kompania ishte e angazhuar në procedurat ligjore të filluara kundër Kompanisë në shumën prej 9,602 mijë EUR. Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2023, Kompania njohu provizion në vlerë prej 197 mijë EUR. Provizionin e njohur pasqyron vlerësimin më të mirë të Menaxhmentit për rezultatin më të mundshëm.

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023 Kompania ka njohur provizione në vlerë prej 5,728 mijë, nga të cilat 1,513 mijë EUR kanë të bëjnë me procedurat ligjore të filluara kundër kompanisë (Shënimi 30 Zotimet dhe kontigjencat) dhe 4,215 mijë EUR kanë të bëjnë me provizionet për detyrimet tregtare që dalin nga zëjidhiet e diskutueshme me dy furnitorë.

Me 5 maj 2023 ZRrE ka marre vendimin Nr V_1739 _2023 dhe ka penalizuar KOSTT-in në vlere prej 439 mijë Euro. KOSTT ka kundërshtuar këtë vendim dhe lënda është në proces gjyqësorë. KOSTT nuk ka ndarë provizion për rastin në fjalë sepse menaxhmenti bazuar në faktet e prezentuara në gjykatë vlerëson se kjo çështje do të vendoset në favor të KOSTT Sh.a.

Marrëveshjet

Marrëveshjet aktuale të huasë ndërmjet kompanisë dhe huadhënësve kërkojnë që Kompania të mbajë marrëveshjet e saj financiare brenda kufijve të kërkuar të përcaktuar në marrëveshjet e huasë. Raporti aktual i llogaritur në bazë të të dhënave financiare është brenda kufirit të kontraktuar.

Zotimet

Më 31 dhjetor 2023 punët e kontraktuara me kompanitë janë në shumën prej 9,870 mijë EUR (31 dhjetor 2022: 9,721 mijë EUR).

Pasuritë e lëna peng

Asnjë nga pasuritë e Kompanisë nuk është lënë peng si siguri për huazimet.

33 NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Më 29 janar 2024 sipas vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) nr. V_1834_2024 ndryshohet, respektivisht fshihet neni 5 i Licencës nga Operatori i Transmisionit të Energjisë Elektrike dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a. për kompensimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës.

KOSTT lirohet nga obligimi i mbulimit/kompensimit të humbjeve në pjesën veriore të Kosovës nga 1 Janar 2024.

Përveç atyre siç përshkruhen si më lartë, nuk ka asnjë ngjarje pas datës së autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.